



Bashkia Berat

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2018 - 2020

QERSHOR 2017

Pergatiti : Grupi per Manaxhimin Strategjik





P E R M B A J T J A

Kapitulli I. Informacion i pergjithshem mbi Programin Buxhetor Afatmesen (PBA) 2018 - 2020

Hyrje Profili i Bashkise Berat

1. Qellimet e PBA
2. Objektivat e PBA
3. Kush perfshihet ne PBA.

Kapitulli II. Plani Financiar i Bashkise Berat 2018 – 2020

Kapitulli III. Programet Buxhetore Afatmesme,

1. Programi : Planifikim, Menaxhim, Administrim
2. Programi : Zhvillimi Ekonomik
3. Programi : Sherbime Publike
 - 3.1 Mirembajtja e siperfaqjeve te gjelberta, mirembajtje varreza publike & deshmoreve .
 - 3.2 Pastrimi i dhe largimi i mbeturinave.
 - 3.3 Menaxhimi rrugor , ndricimi publik dhe dekori.
 - 3.4 Emergjencat Civile .
4. Programi: Zhvillimi i Kultures, Turizmit, Rinise dhe sportet
5. Programi: Kujdesi Social (Perfshi Qendren “Lira”)
6. Programi: Arsimi, parauniversitar dhe cerdhe (perfshi edhe konviktete)
7. Programi: Administrimi i ujrave, zhvillimi i bujqesise, pyjeve lokale dhe sherbimi veterinar.
8. Programi: Planifikimi dhe zhvillimi i territorit .
9. Programi: Menaxhimi i pronave bashkiake dhe strehimi.
10. Programi: PMNZSH

Kapitulli IV. Alokimi i Fondeve sipas Programeve



Bashkia Berat

Kapitulli I. Informacion i pergjithshem mbi Programin Buxhetor Afatmesen (PBA) 2018 - 2020

Profili i Bashkise Berat

Bashkia e Beratit shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum. I cili kalon përmes qytetit të Beratit.

Shtrirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peisazheve gjeografike.

Me ndarjen e re administrative, Bashkia Berat, përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.

Sipërfaqja e Bashkisë Berat është 380 km², nga 22.4 km² që ishte para Reformës Administrative Territoriale 2014. Ndryshimi i kufirit territorial është sfidë për bashkinë në zhvillimin e mëtejshëm.

Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km ²) ⁱ	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre ⁱⁱ
Berat	Qyteti Berat	Berat	19 km ²	Qyteti Berat
		Otlak	52.7 km ²	Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak.
		Velabisht	93.2 km ²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
		Sinjë	138.5 km ²	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezet 1, Osmenezet 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
		Roshnik	78.7 km ²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Berati njihet për arkitekturën, vlerat historike, kulturore, artistike dhe fetare. Është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe kalasë, Muzeu Kombëtar i



Bashkia Berat

Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë). Historia 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. I shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Vlerat e spikatura turistike të cilat lidhen me qytetin muze 2,400 vjeçar të Beratit, parkun kombëtar të Tomorrit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur janë kthyer në mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik për Beratin. Ekonomia e qytetit të Beratit mbështetet në shërbime.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë ruajtur karakterin rural. Sektori kryesor i ekonomisë në këto njësi është bujqësia. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona. Gjithashtu dhe blegtoaria dhe përpunimi i produkteve të mishit dhe qumshtit janë të zhvilluara në këto njësi. Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare.

1. Qellimet e PBA

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është parashikimi për tre vjet i planeve të shpenzimeve të buxhetit përmes lidhjes së drejtepërdrejte të programeve me veprimtaritë, objektivat dhe qellimet e politikës.

PBA është përcaktuar si një proces buxheti shumë vjeçar, integruar, me baze të gjera dhe i orientuar nga performanca .

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2018- 2020.

Ne zbatim të Ligjit nr. 9836 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 10/1 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, me Urdherin e Kryetarit të Bashkisë nr. 349 datë 20.03.2017 “Për Ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programit (EMP).” U bë njohja me UMF nr. 10/1 dt.28.02.2017 , shkresën e MF nr.2739/6 prot.datë 15.03.2017 . Hartimi i kalendarit të hapave të procesit.

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është mbështetur në dokumentat baze :

- Strategjia e Zhvillimit për Teritorin e Bashkisë Berat (hartuar me mbështetjen teknike të projektit PLGP të Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar dhe Co-Plan)
- Strategjia dhe Plani i Veprimit të Turizmit për periudhën 2011 – 2021.
- Strategjitë Sektoriale që janë të lidhura me kompetencat e pushtetit vendor.
- Plani i shpenzimeve për mirmbajtje të infrastukturës në ujë dhe energji.
- Plani i shpenzimeve për Pyllzime të reja, sisteme malore, trajtime silvikulturore .

Parashikimi i treguesve ekonomik-financiar për periudhën 2018 -2020 është mbështetur në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 10/1 datë 28 .02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, duke përfshirë Transferten e Pakushtezuar si dhe Totalin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore e të Ardhura të tjera.



Bashkia Berat

Totali i te ardhura se bashku me transferen e pakushtezuar dhe transferen specifike do te mbulojne funksione e veta, te perbashketa e te deleguara, te cilat i ushtron njesia e qeverisjes vendore deri ne vitin 2017.

Sipas udhezimit te mesiperm :

- Ne rast se do te kete funksione shtese ne tre vitet e ardhshem, do te kete edhe shtese te transfertes se pakushtezuar.
- Niveli i transfertes se pakushtezuar te parashikuar ne tre vitet e PBA-se :
 - Per vitin 2018 eshte parashikuar 2 % me e larte se ajo e vitit 2017
 - Per vitin 2019 eshte parashikuar 5.4 % me e larte se ajo e vitit 2018
 - Per vitin 2020 eshte parashikuar 10.3% me e larte se ajo e vitit 2019

Theksojme se qellimi i kesaj PBA-je eshte prezantimi i strategjive apo politikave te Bashkise me terma financiar dhe tendencat e mundshme te te ardhurave dhe shpenzimeve, nisur nga situatat aktuale, dhe nuk parashikon nje plan te sakte te te ardhurave dhe shpenzimeve.

E ardhmja kushtezohet gjithashtu edhe nga faktore qe nuk varen nga Bashkia por nga Pushteti Qendror, sic eshte rasti i ndryshimeve te politikave fiskale ne nivel vendor, implementimi i politikave fiskale nacionale me impakt lokal, transferimi i funksioneve te reja prane pushtetit lokal etj.

Per kete arsye parashikimet do te rishikohen cdo vit per te reflektuar ndryshimet ne politikat sektoriale te bashkise, reflektime qe do te pasqyrohen ne **PLAN BUXHETIN** vjetore, te cilat do te analizohen, diskutohen dhe vendimohen ne Keshillin Bashkiak .

FUSHAT PRIORITARE :

Ne programin arsimit parauniversitar dhe te edukimit, si fushe prioritare:

1. Rikonstuksion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Nj.A.Velabisht. (me fonde te buxhetit te shtetit)
2. Rikonstruksion i Kopshteve nr.1,2,3.
3. Rikonstruksion Cerdhja nr.7 .

Ne programin e shërbimeve publike: Ne infrastrukturën rrugore janë parashikuar;

RIKONSTRUKSION I AKSEVE RRUGORE TË AMORTIZUARA NË QYTETIN E BERATIT DHE NJESITE ADMINISTRATIVE.

1. Rikonstruksion i bulevardit “Republika” (Aksi Stadium i vjetër Stadiumi i ri).
2. Riasfaltim I segmenteve te rruges “Antipatrea”.
3. Rikonstruksion rrugesh te brendshme ne lagjen 30 Vjetori “Ish-pyjorja”.
3. Rikualifikim Urban ne Lagjen “Clirim”.
4. Shtrim rrugesh me beton dhe ndertim ursh dhe lulishtes ne njesite Administrative dhe ne lagjet e Qytetit.
- 5.Rikonstruksion rrugesh dhe qendra e e fshatit Bilc. Nj.A.Velabisht
6. Ndicim rrugesh ne fshatin Dyshnik. NJ. A .Otlak



Bashkia Berat

RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE DHE UJËSJELLËSIT

1. Rikonstruksion i rrugëve te brendshme dhe KUZ fshati Morave. NJ. A .Otlak
2. Rikonstruksioni i mjetit KUZ dhe ujerave te larta ne lagjen “Donika Kastrioti”
3. Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit ne fshatin Qereshnik. NJ. A .Otlak
4. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Lapardha. NJ. A .Otlak
5. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Drobonik. Nj.A.Velabisht
6. Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit ne fshatin Duhanas. Nj.A.Velabisht
7. Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit ne fshatin Mbreshtan . Nj.A. Sinje

BUJQESIA DHE ADMINISTRIMI I UJRAVE

Reabilitimi i Kanalit Ujites BRU-27 Ullinjas, Reabilitimi i Kanalit Ujites Duhanas, Reabilitimi i Kanalit Velabisht –Starove, Reabilitimi i Kanalit Ujites Gjeroven -Starove, Reabilitimi i Kanalit Ujites Mbolan, Reabilitimi i Kanalit Ujites Uznove, Reabilitimi i Kanalit Ujites Lapardha) Reabilitimi i saraqineskes se Rezervurit Roshnik,. Reabilitimi i saraqineskes se Rezervurit Mjeshove, Reabilitimi i saraqineskes se Rezervurit Uznove, Reabilitimi i shkarkuesit katastrofik ne Rezervurin Mbolan).

Do te aplikohet per fonde ne Ministrine perkatese.

NE PROGRAMIN E KULTURES DHE SPORTEVE

1. Ndertimi i muzeut ne fshatin Sinje NJ.A.Sinje
2. Rikonstruksioni i stadiumit : “Tomorri”
3. Pajisje me fondin e librave te bibliotekes “V.Buharaja”

TE TJERA, MAKINERI DHE PAJISJE

1. Fasadat ne hyrje te qytetit.
2. Sistemi i kondicionimit i godinës se bashkise.
3. Automjet për zjarrfikëse.
4. Fadromë për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.
5. Ne vitin 2014 ka filluar shlyerja e kredisë se CEB (Banka per zhvillim e Keshillit te Europes), kredi e cila u perdor per ndertimin e 48 apartamenteve te banesave sociale. Respektivisht ne vitet 2018, 2019, 2020, do te shlyhet kësti i kredisë sipas kuotave te përcaktuara ne shkresën e Ministrisë se Financave dhe te përfshira ne ketë PBA.

Cfare parashikojme ne kete Program Buxhetor Afatmesem 2018-2020:

1. Vijimin e shërbimeve publike te pastrimit, mirëmbajtjes se varrezave publike dhe te deshmoreve, mirëmbajtjen e lapidareve , dekorin festiv edhe ne njesite administrative, pjese perberese te bashkise se re Berat.



Bashkia Berat

2. Mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldremeve , mirembajtjen e sistemit te ndricimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin, ne Njesite Administrative nr. 1 , nr. 2 , nr. 3 , si dhe ne njesite administrative Roshnik , Otlak , Velabisht , Sinje.
3. Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitet adminisitrative të Bashkisë Berat (Qytet dhe Njesite Admiistrative).
4. Ofrimi i nje sherbimi me cilesor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
5. Funksionimi i Zyres me me nje ndalese, per nje sherbim sa me korrekt dhe ne kohe reale me komunitetin , me kontributin dhe mbështetjen e USAID.
6. Clirimin e buxhetit te Bashkise nga detyrimet financiare dhe shpalljen e ofertes se hapur per shitjen e aksioneve per Futboll Klub “Tomori 1923 sh.a”.
7. Menaxhimin e qendrueshem dhe afat gjate te pyjeve dhe kullotave , shtimin e te ardhurave ne buxhetin lokal nga shfrytezimi i burimeve natyrore .
8. Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkerendimi i punes me institucionet qendrore per sistemin e ujrave te larta te stuhive .
9. Nevojen per investime (Trajtuar ne programin e Planifikimit te Teritorit dhe Investimeve) dhe sigurimin e burimeve te tjera financimi pervec te ardhurave te Bashkise, FZHR, edhe nga donatoret dhe nga partneret nderkombetar.
10. **Rritje te transparences mbi shpenzimet dhe buxhete** . Me ndihmen e *Projekti i USAID –Per Planifikim dhe Qeverisje Vendore (PLGP)* në bashkëpunim me Institutin Shqiptar te Shkencave (AIS) te cilet kanë ideuar dhe finalizuar një platformë me disa instrumente ICT **për transparencë mbi shpenzime dhe buxhete të njësive të qeverisjes vendore.**

- Nën moton Qeverisje Transparente si Qeverisje e Mirë /*Open Governance as Good Governance* me qëllim rritjen e transparencës, mirëstrukturimin e informacionit, komunikimin e institucioneve me bashkitë dhe krijimin e mjeteve që ndihmojnë në rritjen e njohurive dhe nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje.
- Rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës dhe aktorëve civil në përdorimin e instrumenteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për transparencë dhe mirëqeverisje.

Shperndarja e shpenzimeve sipas programeve ka keto specifika :

- Per shkak te zbatimit te politikave sektoriale kemi mbeshtetje te njesive shpenzuese me fonde per shpenzime korrente, per progremet e sherbimeve publike si Gjelberimi, Menaxhimi Rrugor dhe Ndicimi Publik, Programeve kulturore, arsimit dhe zhvillimit te sportit.
- Eshte rritur ne teresi kostoja e cdo programi buxhetor, per shkak te rritjes se cmimit te tregut.
- Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit edhe per 3 vitet e ardhshem mbetet ne vemendje te funksioneve te perbashketa te njesise se qeverisjes vendore. Shtesa e fondeve nga njeri vit ne tjetrin kushtezohet nga rritja e cmimit te karburanitit, energjise elektike, ujit, mallrave te konsumit te gjere etj.



Bashkia Berat

- Nga viti 2014 e ne vijim kryhet shlyerja e kredise CEB per ndertimin e banesave sociale te dhena me qera, perlllogaritja e se ciles eshte bere duke zbritur te ardhurat e grumbulluara nga vjelja e qerases, duke vijuar cdi vit te shlyejme detyrimet financiare te keshtit te kredise.
- Studimet social ekonomike, si pjese e Strategjia e Zhvillimit per Teritorin e Bashkise Berat Strategjise se Turizmit, kane rritur besueshmerine tek partneret serioz si Banka Euporiane per Zhvillim, CEB, KE, Banka Boterore, SOROS, Co-Plan, Instituti per Zhvillimin e Habitatit, TIKA, PNUD, ASED, REC, bashkepunimet me te cilet do je jene ne fokusin e punes sone ne periudhen ne vijim.
- Implementimi i projekteve ne fushen e trashegimise, statusit te qytetit si pasuri e UNESCO-s, rrjetezimi i Beratit ne sistin e Qyteteve Europiane te Artit, projekti SUSTCULT i financuar nga BE do te kene impak pozitiv ne rritjen e vlerave promovuese te qytetit.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në potencialin e nivelit të gjenerimit të të ardhurave. **Parashikimi i shpenzimeve** është bërë në bazë të strategjive sektoriale afatgjata të investimeve të Bashkisë dhe reflekton prioritetet e investimeve të Bashkisë në periudhën afatmesme.

Me poshtë prezantohet plani financiar i Bashkisë, për periudhën 2018 -2020.

ne/000 leke

	FINANCIMET					
		Fakt 2016	Pritsh. 2017	Projekt 2018	Projekt 2019	Projekt 2020
1	Transferta e pakushtezuar	219,580	255,250	260,355	274,414	302,679
2	Transferta specifike	221,932	233,867	233,866	233,866	233,866
I.	Shuma e transfertes	441,512	477,209	494,221	508,280	536,545
3	Te ardhurat lokale	277,386	430,427	445,400	458,762	472,524
4	Te ardhura te trasheguara	79,542	78,448	78,448	78,448	78,448
II	Shuma e te ardhurave	356,928	508,875	523,848	537,210	550,972
	Totali te ardhurave te veta	798,440	986,084	1,018,069	1,045,490	1,087,517
5	Qerate e Babesave sociale	4,295	4,295	4,301	4,307	4,350
6	Depozite bankare nga qerate e banesave sociale	15,067	19,362	23,657	27,958	32,265
III.	Shuma e Qerave B,S.	19,362	23,657	27,958	32,265	36,615
IV.	Fondi Zh.Rajoneve/qeveria	258,703	303,944			
	Shuma e financimeve	1,081 106	1,329,888	1,050,328	1,082,062	1,128,482

KAPITULLI III Programet Buxhetore Afatmesme

1. Programi i administrates se bashkise (planifikim, menaxhim, administrim)





Bashkia Berat

Ky program parshikon manaxhimin financiar te Bashkise Berat dhe perfshin shpenzimet e nevojshme administrative per mbarvajtjen e punes ne permbushjen e funksioneve te percaktuara ne legjislacion. Pas zbatimit te ligjit per Zbatimin e Reformes Teritoriale dhe zmadhimit te Bashkise mbështetur ne Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” ky program mer nje dimension te gjere.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë Berat, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit te vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë

Njësitë shpenzuese

Ne mbështetje te Ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 109 date 22. 12.2016 u miratua numri i pergjithshem i punonjësve, dhe Kryetari i Bashkise me Vendimin nr. 890 date 24.12.2016 miratoi strukturen organizative te administres se Bashkise dhe te njesive vartese te saj. Ne zbatim te VKM nr. 177 date 08.03.2017, per disa ndryshime ne VKM nr.165 “Per grupimin e njesive te veteqeverisjes vendore, per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionareve te zgjedhur dhe te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive te vetqeverisjes vendore”, me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr. 24 datë 30.03.2017 “Mbi miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkise, njesive vartese dhe shpërblimi i kryetareve te fshatrave” u miratua niveli i pagave te punonjësve.

Ne funksion dhe ne zbatim te ligjeve dhe VKM –ve te sipërcituara, miratimi i kësaj strukture ka sjellë përcaktimin më të qartë të roleve dhe detyrave të përgjithshme dhe specifike të organizimit të punës, marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike dhe paralele, duke përcaktuar dhe qartësuar më mirë kompetencat e çdo njësie të strukturës organizative, duke rritur cilësinë dhe efektivitetin e tyre, me qëllim që të rritet efica e procedurave që realizon institucioni në tërësi. Kjo strukturë e re i përgjigjet më mirë zhvillimeve të reja dhe kërkesave në rritje per nje teritor me te zgjeruar, për një shërbim në ndihmë të komunitetit në përputhje me standartet bashkëkohore. Ky ndryshim në strukturën e Bashkisë së Beratit reflekton nevojën për rishikimin edhe të strukturave aktuale të institucioneve në varësi të saj, për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e tyre të brendshëm, e cila do të ndikojë drejtpërsëdrejti në zbatimin e politikave përkatëse dhe të shërbimeve që ato realizojnë në praktikën e tyre të përditshme për përmbushjen e nevojave të komunitetit me të cilin ato operojnë.

Objektivat e politikës së programit:

- a. Vendosja e standardeve te reja ne menaxhimin e burimeve njerëzore mbi bazen e meritokracise dhe profesionalizmit ne rekrutimet ne sherbimin civil.
- b. Fuqizimi i kapaciteteve te burimeve njerezore ne Bashki ne menyre qe ti pergjigjen realizimit te vizionit per te ardhmen e qytetit.



Bashkia Berat

- c. Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor dhe me etike ndaj qytetarëve.
- d. Te ofrojmë një partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.

Produktet që synohen të ofrohen

- a. Plotesim i 100% me nënpunës e punonjës i strukture organizative të miratuar, në baze të politikave të përcaktuara për rekrutim, seleksionim dhe emerimin e punonjësve civilë, si dhe marrjen në punë të nënpunësve dhe punonjësve të tjerë.
- b. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe shërbimit për qytetarët, venia në efikasitet dhe efikasitet të bashkësive të ndërtuara të ish shtëpive të ushtarakeve.
- c. Venia në efikasitet të Zyres me një ndalesë.
- d. Instalimi i sistemit të rrjetëve kompjuterike për administratën (përmirësim i sistemit të IT).
- e. Implementimi i sistemit PAV (platforma e administratës vendore) dhe krijimi i Regjistratës Qendrore të personelit të administratës vendore. (përfutjes të projektit të financuar nga Fondet e Qeverisë zvicerane, Këshilli i Europës.)
- f. Shtrirja e Sistemit Informatik të Administrimit të Taksave (TAIS) edhe në njësitë administrative Roshnik, Sinje, Velabisht dhe Otllak. (për biznesin).
- g. Implementimi i sistemit të administrimit të financave vendore, mbështetur nga USAID.
- h. Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet dhe potencialin e tyre.
- i. Në bashkëpunim me ASPA, siguri i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime.

Aktivitetet që synohen të realizohen

- Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për nënpunësit dhe punonjësit e bashkësive.
- Plotesimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë.
- Siguri i materialeve dhe shërbimeve speciale.
- Realizimi i shërbimeve ndaj të tjerëve.
- Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Siguri i levizjes së nënpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vet ambienteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve për pritje përcjellje.
- Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.



2. PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK

Pershkrimi i Programit

Programi i zhvillimit ekonomik përpiket të bëjë bashkërendimin e planeve dhe politikave buxhetore me nevojat ekonomike të Bashkisë Berat.

Ne themel të Programit qendron angazhimi maksimal për sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për funksionimin normal të Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Politika e Programit

Krijimi dhe zhvillimi i një mjedisi ekonomik në mënyrë të tillë që të jetë sa më atraktiv dhe konkurrues, i cili do të konsolidojë dhe garantojë qëndrueshmërinë ekonomike gjatë një periudhe afatmesme.

Njësitë shpenzuese

2. Bashkia Berat

Objektivat e politikës së programit

- Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
- Gjetja e menyrave me efikasë për zgjerimin e bazës së taksueshme të bizneseve dhe të familjeve.
- Vlerësim sa më real i detyrimeve të taksapaguesve nga ana e administratës tatimore vendore.
- Ofrimi i një shërbimi me cilësor dhe brenda një kohe sa më të shkurter, në sajë edhe të informatizimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.
- Asistencë dhe këshillim nga administrata tatimore vendore për çdo biznes që kryen aktivitet tregtar si dhe për çdo individ i cili dëshiron të çelë aktivitet të ri tregtar.
- Përmirësimi i administrimit të të ardhurave vendore.
- Mbeshtetje, marketing, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.
- Mbeshtetje e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxitja e sipërmarresve të rinj me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkurruese në rajon.

.Hartimi i politikave për thithjen e biznesit të ri inovativ në bashkinë e Beratit me anë të lehtësimit të taksave dhe subvencioneve

Projektet:

- Organizimi i Panairëve vjetorë të produkteve vendase në Bashkinë Berat.
- Funksioni i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Berat dhe zonave pranë.
- Hartimi i Strategjisë së Marketimit të Produkteve vendase.

.



Bashkia Berat

Produktet që synohen të ofrohen:

Ne 000/leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave	I pritshmi 2017	Parashikimi per vitin 2018	Parashikimi per vitin 2019	Parashikimi per vitin 2020
I.	Të ardhura nga taksa	176,463	183,817	189,331	195,011
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	10,143	12,507	12,882	13,269
2	Taksa mbi Ndërtesat	59,134	60,908	62,735	64,617
3	Taksa mbi token bujqësore	18,406	18,958	19,527	20,113
4	Taksa e fjetjes në hotel	2,869	2,955	3,044	3,135
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	30,000	30,900	31,827	32,782
6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	3,000	3,090	3,183	3,278
7	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	20,510	21,125	21,759	22,412
8	Taksa për zënien e hapësirave publike	14,533	14,969	15,418	15,881
9	Taksa e tabelës	8,843	9,108	9,382	9,663
10	Taksa mbi truallin	8,010	8,250	8,498	8,753
11	Taksa të përkohshme	-	0	-	-
12	Taksa e rentës minerare	-	0	-	-
13	Taksa te tjera	1,015	1,045	1,077	1,109
II.	Të ardhura nga tarifat	148,201	152,647	157,226	161,943
1	Tarifa për pastrim	65,380	67,341	69,362	71,442
2	Tarifa për hapësira publike		0	-	-
3	Tarifa ujit te pijshëm		0	-	-
4	Tarife ndriçimi rrugor	25,576	26,343	27,134	27,948
5	Tarife table	-	0	-	-
6	Tarife gjelbërimi	13,371	13,772	14,185	14,611
7	Tarifa për Reklame	-	0	-	-
8	Tarifa parkimi	1,923	1,981	2,040	2,101
9	Tarifa për therjen e bagëtive	365	376	387	399
10	Tarife për shërbime te tjera administrative	700	721	743	765
11	Tarife për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)	12,400	12,772	13,155	13,550
12	Sporte dhe kultura	-	0	-	-
13	Tarifa te tjera	28,486	29,341	30,221	31,127
III.	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera		111,795	115,026	118,390



Bashkia Berat

		108,658			
1	Shitje Ndërtese		-		-
2	Shitje Troje		-		-
3	Shitje te pronave te ndryshëm		-		-
4	Qera nga Banesat Sociale	4,295	4,301	4,307	4,350
5	Qera nga Ndërtesat	104,363	107,494	110,719	114,040
6	Interesa nga te ardhurat		-		-
IV.	Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme		-		-
V.	Të ardhura të tjera	103,505	107,848	112,198	116,593
1	Kredi dhe Hua		0	-	-
2	Dhurata dhe sponsorizime te ndryshme		0	-	-
3	Te ardhura nga gjobat	1,400	1,442	1,485	1,530
4	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar	78,448	78,448	78,448	78,448
5	Depozite bankare nga Qerate e Banesave Sociale	23,657	27,958	32,265	36,615
VI	Totali i te ardhurav te veta (I+II+III+IV+V)	536,827	556,107	573,782	591,937
VII	Te ardhura te kushtezuara	793,061	494,221	508,280	536,545
1	Transferta te kushtezuara				
2	Transferta specifike	233,867	233,866	233,866	233,866
3	Transferta te pakushtezuara	255,250	260,355	274,414	302,679
4	Fondi i Zhvillimit te Rajoneve	303,944			
VIII	Te ardhurat gjithsej (VI+VII)	1,329,888	1,050,328	1,082,062	1,128,482

3. PROGRAMI I PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I TERRITORIT .

Pershkrimi i Programit

Programi për planifikimin e territorit dhe investimeve synon implementimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit, i cili tani është në hapat e fundit të hartimit dhe miratimit të tij.

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Beratit

“Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat e qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture moderne, si një destinacion i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse/pritëse për një rajon të pasur natyror.

Qëllimi kryesor është: harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.



Bashkia Berat

Politika e programit

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Strategjia e zhvillimit të qytetit të Beratit është e përbërë nga gjashtë objektiva strategjike të cilat janë trajtuar në materialin **Programi Buxhetor Afatmesëm 2017-2019**.

Plani i Investimeve Kapitale si pjesë e projekt-buxhetit afatmesëm për vitet 2018_2019_2020

Identifikimi dhe vlerësimi i projekteve kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjik të Strategjisë të Zhvillimit të Territorit, të reflektuar gjithashtu edhe në propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Referuar pamundësisë së financimit të të gjithë projekteve të identifikuara në tabelën përmbledhëse të nevojave për investime kapitale, është bërë procesi i prioritarizimit dhe përzgjedhjes së projekteve të investimeve mbi bazën e një sërë kriteresh të dakordësuara me aktorët.

Kriteret marrin në konsideratë tre çështje kryesore:

- (i) koston e investimit;
 - (ii) jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit;
- koston e mirëmbajtjes.

Kategoria e Infrastruktura Rrugore:

Disa nga akset kryesore të cilat mundësojnë lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme të qytetit të Beratit kanë shfaqur shenja amortizimi nga përdorimi ndër vite. Kjo gjë ka shkaktuar vështirësimin e kalimit të qytetarëve me automjete dhe kalimin e këmbësorëve nga dëmtimi ose mungesa e trotuarëve në disa segmente përgjatë këtyre akseve. Në total janë 8.7 km rrugë të amortizuara të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu cilësia e ajrit është një problem për qytetarët që banojnë ose ushtrojnë aktivitetin ekonomik pranë këtyre akseve rrugore.

- **RENDI PRIORITAR NR.1**

☐ Ndërtimi i Bypass të qytetit të Beratit

- **RENDI PRIORITAR NR.2**

☐ Segmenti rrugor qëndër e qytetit – Uznovë;

☐ Rruga “Santa Lucie Filipine”;

☐ Sheshi “Akhensia” (Sheshi i harmonisë Fetare);

☐ Rruga “Gaqi Gjika”;

☐ Rruga në zonën e quajtur “Kodra e Sulmit”;

☐ Segmenti rrugor Shish-Ura e Re – Shkolla Industriale;

☐ Rrethrotullimi në segmentin rrugor “Kinoklubi-Ura e Goricës”.

☐ Rikonstruksion i rrugës Sinjë-Mbjeshovë, i rrugës në fshatin Mbolan, i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë).



Bashkia Berat

- ☐ Rikonstruksion i segmentit rrugor Bilçe- Malinat (Njësia Velabisht)
- ☐ Rikonstruksion i rrugës Sinjë – Mbjeshovë (Njësia Sinjë)
- ☐ Rikonstruksion i rrugës në fshatin Mbolan (Njësia Sinjë)
- ☐ Rikonstruksion i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë)
- ☐ Ndërtim i mureve mbajtëse të rrugës Berat-Bilçe

Kategoria Nderhyrje ne hapësira Urbane:

Rikonstruksion i fasadave të godinave pergjate Rruges Antipatrea.

Rikonstruksion i hapësirave urbane në lagjen “Murat Çelebiu” .

- Kategoria Mjedisi:

Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë

Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli .

- Kategoria Ujesjelles Kanalizime:

1. Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat;
2. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të larta, faza e III segmenti Burdullias-lumi Osum, Berat;
3. Rikonstruksionin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin dhe ndërtim i rrjetit në fshatra (Mbreshtan, Sinjë, Lapardha, Otlak);
4. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Velabisht, Duhanas, e Dushnik;
5. Studim dhe hapje pusi për ujë të pijshëm në fshatin Mbreshtan, Sinjë;
6. Rikonstruksion ujësjellësi Roshnik.

- Kategoria Mbrojtja e trashëgimise Kulturore dhe Turizmit:

Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes “Mangalem”

Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint

Restaurimi i godinave të amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri, në zonat historike

- Kategoria Arsim:

Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare në fshatin Veternik, njësia Velabisht



Bashkia Berat

Analitikisht lista prioritare eshte si me poshte:

Plani i Investimeve Kapitale si pjese e projekt-buxhetit afatmesem per vitet 2018_2019_2020

OBJEKTIVI	PROGRAMI	PROJEKTI I INVESTIMIT	NjA
O1: Zhvillim hapësinor inovativ, cilësor dhe i planifikuar	O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy qendërve ekonomike rajonale, pranë njësisë Otlak dhe Velabisht	PR1: Hartimi i PDV-së dhe mundësimi i zhvillimi të zonës ekonomike pranë fshatit Otlak dhe Velabisht	Otlak, Velabisht
	O1P2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzsituase urbane të njësive administrative	PR2: Rigjenerimi dhe rivitalizmi i qendrave të Njësive Administrative	Otlak, Velabisht, Sinje, Roshnik
	O1P3: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumentëve financiarë, dizajnit urban dhe PPP-ve	PR3: Rikonstruksion i hapësirave urbane në lagjen “Murat Çelebiu”	Berat
		PR4: Rikonstruksion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit	Berat
		PR5: Rikualifikim dhe rikonstruksion i hapësirës Urbane, Lagja “Barrikadë”	Berat
			Berat
		PR7: Ndërtim i fushave sportive në lagjet: “A.Xhindole”, “Xh. Cekini”, “28 Nëntori”	Berat



Bashkia Berat

O2: Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional	O2P1: Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kondrinore-malore	PR1: Përcaktimi i itinerareve dhe destinacioneve tërheqëse për turizmin në qytet në zonat kodrinore-malore duke krijuar një kalendar veprimtarish vjetore	Berat
		PR2: Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint	Berat
	O2P2: Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Goricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik	PR3: Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes “Mangalem” (16 banesa)	Berat
		PR4: Restaurimi i godinave të amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri, në zonat historike	Berat
			Berat
			Berat
	O2P3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar, hotelier dhe informativ për turistët në qytetin e Beratit si dhe përgjatë rrugëve panoramike dhe peizazhistike	PR7: Krijimin e paketave të reja turistike	Berat
		PR8: Shtimi i zyrave të informacionit për turistët	Berat
		PR9: Krijimi i pikave të shitjes së produkteve artizanale	
	O2P4: Mbështetja me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësinë Roshnik	PR10: Evidentimi i itinerareve peizazhistike në Roshnik	Roshnik
		PR11: Krijimi i paketave turistike për promovimin e ekoturizmit	Berat
	O2P5: Mbrojtja e sistemit urban nga përmytjet e Lumit	PR12: Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane	Berat



Bashkia Berat

	Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor	PR13: Menaxhimi i integruar i ujërave të Lumit Osum	Berat
	O2P6: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ si dhe ndërtimi i impantit të trajtimit të ujërave të zeza	PR14: Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat	Berat
			Berat
		PR16: Rikonstruksioni i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin dhe ndërtim i rrjetit në fshatra (Mbreshtan, Sinjë, Lapardha, Otlak)	Otlak, Velabisht, Sinjë, Roshnik
		PR17: Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Velabisht, Duhanas, e Dushnik	Velabisht
			Sinjë
		PR19: Studim dhe hapje pusi për ujë të pijshëm në fshatin Mbreshtan, Sinjë	Sinjë
		PR20: Rikonstruksion ujësjellësi Roshnik	
	O2P7: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale	PR21: Hartimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave	Otlak, Velabisht,
		PR22: Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë	Berat
	O2P8: Modernizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe ndërtimi i një landfilli rajonal për menaxhimin e mbetjeve	PR23: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli	
		PR24: Ndërtimi i një stacioni riciklimi	



Bashkia Berat

		PR25: Ndërtim te një stacioni transferimi për mbetjet urbane	
O3: Garantimi i aksesit hapësinor	O3P1: Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat në funksion të trafikut ndërqytetas	PR1: Ndërtimi i Bypass të qytetit të Beratit [Qeveria Qendrore]	
	O3P2: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare	PR2: Rikonstruksion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit	
		PR4: Rikonstruksion i rrugës Sinjë-Mbjeshovë, i rrugës në fshatin Mbolan, i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë)	Sinje
	O3P3: Menaxhimi i trafikut lokal përmes sistemit të informacionit dhe ndërhyrjeve pikësorë në infrastrukturë	PR5: Krijimi i sinjalistikës rrugore pajisja me semaforë e kryqëzimeve	B.Berat
		PR6: Shtimi i zonave të parkimeve publike në qytetin e Beratit	B.Berat
	O3P4: Hartimi dhe zbatimi i një plani sektorial të transportit publik të integruar për Bashkinë Berat	PR7: Hartimi i planit sektorial të integruar të transportit	B.Berat
O4: Zhvillim bujqësor e rural	O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkërendim i punës me institucionet qendrore për sistemin e ujërave të larta	PR1: Rehabilitimi i stacionit të elektropompave	
		PR2: Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta	
		PR3: Mbrojtja nga përmblytjet në zonë. Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse	
			Berat



Bashkia Berat

	O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore nga zhvillimet urbane	PR5: Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore	
	O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë përmes PPP-ve dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve	PR6: Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartëzimit të pronave publike, subjekt transferimi në bashki dhe përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike	
		PR7: Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore	
		PR8: Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat e përshtatshme	
	O4P4: Mbarështimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në blegtori e bujqësi	PR9: Hartimi i politikave për kultivimin e tokave bujqësore dhe kullotave nëpërmjet subvencioneve	

4. PROGRAMI I SHERBIMEVE PUBLIKE Mirëmbajtjes së rruge, trotuareve dhe ndicimit publik

Pershkrimi i Programit

Programi i Mirëmbajtjes së rruge trotuareve dhe ndicimit publik ne Njesite Administrative nr. 1 , nr. 2 , nr. 3 , ne njesite organizative Roshnik , Otllak , Velabisht , Sinje parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldremeve , mirembajtjen e sistemit te ndricimit të qytetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, dhe ne njesite administrative me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukture dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te ndicimit publik.



Bashkia Berat

Njësitë Shpenzuese

- Bashkia Berat
- Ndërmarrja e Sherbimeve Publike

Objektivat e Programit

- Permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Rritja e siperfaqeve te shtruara me kalldrem ne masen 4.3 %, per periudhen 2017.
- Te mirëmbahen trotuaret , kalldremet ekzistuese dhe te shtohen siperfaqet e reja te tyre.
- Te mirembahet rrjeti ekzistues i ndicimit publik dhe te mundesohet mbulimi i zonave te reja me ndicim.

Produktet qe synohen te ofrohen

1. Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.

Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës.

Siperfaqja totale e rrugeve eshte 857 323 m2 ne te gjithë territorin e Bashkise nga te cilat 239 231 m2 jane te trajtuara me asfalt dhe 618 092 m2 me stabilizant.

- **Mirmbajtje e urave 13 cope**

- 1- Ura e Gorices me gure
- 2- Ura e Varur (konstruksion me kavo celiku)
- 3- Ura e Re (konstruksion beton arme me parmak druri)
- 4- Ura e Varur e Gjorovenit me derrasa
- 5- Ura e Varur e Lapardhase me derrasa

2. Mirëmbajtja e Rrugëve me kalldrem dhe trotuareve.

Mirmbajtja e rrugeve ekzistuese me kalldrem dhe shtimi i siperfaqeve te reja . Gjithsej kemi 80 942 m2 qe do te mirmbahen.

Per vitin 2018 do te shtohen 3500 m2 te reja ne keto segmente rrugore :

- Rruga Kostandin Kristoforidhi 1200 m2
- Rruga Lisi i Becit 620 m2
- Rruga Vangjel Zoto 1680 m2

Per vitin 2019 do te shtohen 4200 m2 te reja ne keto segmente rrugore :

- Rruga Zogu i Pare 660 m²
- Rruga Ajete Xhindole 630 m²



Bashkia Berat

- Rruga Andrea Sahatciu 850 m²
- Rruga Ramadan Zdrava 470 m²
- Rruga Margarita Tutulani 656 m²
- Rruga Besa 360 m²
- Rruga Ara e Tabakeve 574 m²

Per vitin 2020 do te shtohen 6555 m² te reja ne keto segmente rrugore :

- Rruga Shyqyri Fuga 1000 m²
- Rruga Ismail Vrioni 250 m²
- Rruga Nezim Frakulla 880 m²
- Rruga Ymer Berati 1790 m²
- Rruga Sheh Ismaili 650 m²
- Rruga Vlash Papa 595 m²
- Rruga Zihni Toska 1390 m²

3.Mirmbajtja e shesheve

- Sheshi ' Xhimitiku ' 85 m² me asfalt
- Sheshi ' Kumsalla ' 80 m² me kalldrem
- Sheshi ' Sallabanda ' 900 m² me kalldrem
- Sheshi ' Tabia ' 800 m² me kalldrem
- Sheshi ' Shen Gjergji ' 1000 m² me kalldrem
- Sheshi ' Akropoli ' 6500 m² me kalldrem
- Sheshi ' Kostandin i Madh ' 800 m² me kalldrem
- Sheshi ' Onufri ' 60 m² me kalldrem
- Sheshi ' Fusha e Madhe ' 2300 m² me kalldrem
- Sheshi ' Porta e Madhe ' 900 m² me kalldrem
- Sheshi ' Axfensia ' 3700 m² me asfalt
- Sheshi ' Demokracia ' me asfalt
- Sheshi ' Jani Vruho ' 900 m² me asfalt .

4. Mirmbajtja e sistemit te kanalizimeve te ujrave te bardha , te larta dhe i pusetave ne Njesine Administrative nr. 1 , nr. 2 , nr. 3 , Velabisht , Sinje , Otlak , Roshnik.

Mirmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve te ujrave te bardha ne 210 zgara te vogla ekzistuese ne Njesite Admin. Nr. 1 , nr. 2 , nr. 3.

- Mirmbajtja dhe pastrimi kanalizimeve te ujrave te larta ne 30 zgara pritesa te medha ne te gjitha territorin e bashkise
- Parashikohet te vendosen zgara pritesa per ujrata e larta 50 cope ne te gjitha territorin e Bashkise.
- Pastrimi i perrenjve te meposhtem :
 - Perroi i Kananit
 - Perroi i Lisit i Te Becit
 - Perroi i Suelasit
 - Perroi Pusi me Cati



Bashkia Berat

Perroi i MCR

Perroi ne lagjen “ 1 Maji”

- Sistemimi i perroit te Avramit ne lagjen 13 Shtatori
- Sistemimi i ujrave te bardha ne lagjen Kala

5. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

- Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave , duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.
- Vijeziimi i vijave te bardha te kembesoreve me permasa 3 x 0.5 m , ne total 1398 m² ne rruget :
 - Rruga Antipatrea (Ura e Anit – Uznove e Madhe)
 - Rruga Ura e Re
 - Shetitore Osumi
 - Rr. Santa Lucia
- Vijeziimi i vijave gjatesore trafik ndarese me gjeresi 12 cm , ne total 23400 ml ne rruget :
 - Rruga Antipatrea (Ura e Anit – Uznove e Madhe)
 - Rruga Ura e Re
 - Shetitore Osumi
 - Rr. Santa Lucia

6. Mirëmbajtje Ndriçimi Rrugor

- Përfshihet mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrat , riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, qe kap nje gjatesi te ndicuar prej 40 km
 - Shtim i gjatesive te ndicuar ne masen 5m
 - Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndriçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndriçuesi ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
7. Programe manaxhimi dhe ekonomizimi te energjise elektrike nepermjet zevendesimit te llampa ve ekzistuese me llampa ekonomike led.

8. Mjetet e transportit te sherbyera te ndermarrjes se N.SH.P.

- 1- Mjet transporti mbi 2.5 ton 3 cope
- 2- Fadroma 2 cope
- 3- Autokulla 1 cope
- 4- Bomkat 1 cope



Bashkia Berat

5- Motokarro 1 cope

6- Fugon 1 cope

Mjete te transferuara nga njesite administrative ne dt 18.04.2016

7- Autoveture me tr BR 9651 A, cop 1,(mjeti eshte i konsumuar) , i transferuar ne dt 18.04.2016 .

8- Autoveture Mitsubish cop 1. e konsumuar.

9- Kia Sorento cop 1. e konsumuar.

10- Kia Sorento cop 1 . e konsumuar.

1.Rikonstruksion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit

Titulli i projektit	1. Rikonstruksion i segmeneteve rrugore në qytetin e Beratit
Sfondi i projektit	Disa nga akset kryesore të cilat mundësojnë lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme të qytetit të Beratit, kanë shfaqur shenja amortizimi nga përdorimi ndër vite. Duke vështirësuar kalimin e qytetarëve me automjete. Si dhe kalimin e këmbësorëve nga dëmtimi ose mungesa e trotuarëve në disa segmente përgjatë këtyre akseve. Në total janë rret 8. km rrugë të amortizuara të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu cilësia e ajrit është një problem për qytetarët që banojnë ose ushtrojnë aktivitetin ekonomik pranë këtyre akseve rrugore.
Përshkrimi i projektit	Rikonstruksion i akseve rrugore të amortizuara në qytetin e Beratit: 1. Rikonstruksion i bulevardit “Republika” (Aksi Stadium i vjetër Stadiumi i ri). 2. Rikonstruksion i segmentit rrugor qëndër e qytetit – Uznovë. 4. Rikonstruksion i rrugës “Santa Lucie Filipine”. 5. Rikonstruksion i sheshit “Akhensia” (Sheshi i harmonisë Fetare). 6. Rikonstruksion i rrugës “Muzak Topia”. 7. Rikonstruksion i rrugës “Gaqi Gjika”. 8. Rikonstruksion i rrugës në zonën e quajtur “Kodra e Sulmit”. 9. Rikonstruksion i rrugës “Mihal Komneno”. 10. Rikonstruksion i segmentit rrugor Shish-Ura e Re – Shkolla Industriale. 11. Rreth rrotullimi në segmentin rrugor “Kinoklubi-Ura e Goricës”.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR.
Rezultati i pritshëm	Lehtësimi i trafikut automobilistik. Rritja e aksesit. Përmirësimi i cilësisë së ajrit. Rritja e mirëqënies social-ekonomike.
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytetin e Beratit.



Bashkia Berat

Veprimet strategjike	Studimi dhe hartimi i projekteve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në qytet. Përfshirja dhe bashkëpunimi i komunitetit dhe grupit të biznesit që preken drejtëpërdrejt nga këto projekte. Kryerja e proceseve prokuruese dhe/ose aplikimi për fonde, sipas rastit. Lobimi për fonde. Zbatimi i projekteve.
Rrisqet	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Berat dhe grupeve të interesuara.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-Afatgjatë
Kosto financiare	
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm

2. Rikonstrukcion i segmeneteve rrugore në njësitë e bashkisë Berat

Titulli i projektit	Rikonstrukcion i segmeneteve rrugore në njësitë e bashkisë Berat
Sfondi i projektit	Në disa fshatra të njësive Sinjë e Velabisht është evidentuar nevoja për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore. Disa nga segmentet rrugore të cilat lidhin fshatrat ndërmjet tyre janë amortizuar për shkak të përdorimit ndër vite. Duke vështirësuar aksesin ndaj shërbimeve sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Gjatësia në total e segmenteve rrugore që propozohet ndërhyrja është 28.2 km.
Përshkrimi i projektit	Rikonstrukcioni i rrugëve lidhëse ndërmjet fshatrave në njësitë Velabisht e Sinjë: 1. Rikonstrukcion i rrugës Berat – Drobonik (Njësia Velabisht) 2. Rikonstrukcion i segmentit rrugor Bilçe- Malinat (Njësia Velabisht) 3. Rikonstrukcion i rrugës Sinjë – Mbjeshevë (Njësia Sinjë) 4. Rikonstrukcion i rrugës në fshatin Mbolan (Njësia Sinjë) 5. Rikonstrukcion i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë) 6. Ndërtim i mureve mbajtëse të rrugës Berat-Bilçe
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
Rezultati i pritshëm	- Rritja e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet njësive jo urbane me qytetin e Beratit - Rritja e aksesit ndaj shërbimeve që ofrohen në qytetin e Beratit - Rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike për banorët në zonat jo urbane



Bashkia Berat

Objektivi	Të përmirësohet lidhja infrastrukturore ndërmjet njësive urbane dhe rurale.
Veprimet strategjike	- Hartimi dhe rakordimi me planet kombëtare të transportit dhe projektet e qeverisë qëndrore: - Hartimi i projektit - Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde - Përfshirja dhe bashkëpunimi me grupet e interesit (Biznesi, komuniteti etj) - Hartimi i projekteve teknike dhe kryerja e procesit të prokurimit, ose aplikimi për fonde sipas rastit - Zbatimi i projekteve.
Rrisqet	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese, çon në mos përmbushjen e objektivave.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-afatgjatë
Kosto financiare	
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm

PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL

Trajtimi financiar i personave me aftësi të kufizuara, me ndihmë ekonomike si dhe “Raste të vecanta”

Pershkrimi i Programit

Ky program ka për qëllim të vijë në ndihmë personave me aftësi të kufizuara, trajtuesve të ndihmes ekonomike si dhe të përfshijë në skemën e ndihmes ekonomike familjet të cilat nuk përmbushin kriteret për të përfituar nga legjislacioni në fuqi. Pasi gjykohen arsyet pse familja nuk mund të përfshihet në skemë dhe pasi bëhet verifikimi i gjendjes social-ekonomike të familjes Drejtoria e shërbimeve sociale vendos nëse familja mund të trajtohet si rast i vecantë dhe të mbështetet nga fondet e bashkisë.



Bashkia Berat

Politika e programit

Trajtimi i familjeve ne nevojë me ndihmë ekonomike , pagesa e paaftësisë për personat me aftësi të kufizuara (me fonde të buxhetit të shtetit) si dhe trajtimin si “raste të vecanta”, që do të mundësojë vlerësimin financiar të këtyre familjeve (me fondet e bashkisë) duke kontribuar në rritjen e të ardhurave të familjes.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Buxheti i Shtetit**

Objektivat e programit

- Reduktimi i varferisë së familjeve në nevojë.
- Përfshirja në skemë e individëve/grupeve të përcaktuara me ligj
- Përfshirja në skemë si “Raste të vecanta” e individëve/grupeve të përjashtuara nga ligji.

B. Fondi i emergjencës për rastet e dhunës në familje

Përshkrimi i Programit

Në zbatim të VKM Nr 334 dt 17.02.2011 specialisti i shërbimeve sociale , Bashkia Berat ngarkohet me detyrën e koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje. Nder detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit vendor është edhe asistimi i viktimave të dhunës në familje për njohjen e të drejtave të tyre, ndjekja e të gjitha procedurave për marrjen e urdherave të mbrojtjes ,organizimi i takimeve për menaxhimin e rasteve, ndërmjetësimi për sigurimin e nevojave të emergjencës (nevoja psikologjike, keshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim etj) si dhe sigurimi i gjithë informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm rast pas rasti.

Është e nevojshme që për nevojat akute të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, të ekzistojë një fond që do të quhet “Fond i Emergjencës për Rastet e Dhunës në Familje”

Politika e programit

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen dhe asistimin e njerëzve që përjetojnë dhunë në familje, nëpërmjet koordinatorit vendor, në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.



Bashkia Berat

Njësitë shpenzuese

➤ Bashkia Berat

Objektivat e programit

- Ngritja e Qendres se specializuar per akomodimin disa ditor te individeve te dhunuar e qe kane nevoje per strehezen e perkoheshme.
- Permbushje dokumentacionesh (noterime,prokura,nxjerrje certifikatash etj) ne rast se do te paraqitet nevoja.
- Pagesa e vleres se transportit ne rast se do te jete e nevojshme qe te referohet rasti ne streheza jashte qytetit.
- Akomodime 24 ose 48-oreshe sipas rastit te personave te rrezikuar deri ne dergimin e tyre ne qendra te specializuara . (Ky fond mund te sherbeje edhe per akomodimin e individeve ne nevoje qe jo-domosdoshmerisht jane gra te dhunuara si psh persona qe kane nevoja urgjente per strehim disa oresh etj)
- Permbushja e nevojave me urgjente jetesore (ushqim,veshmbathje etj)

C. Kalendari i aktiviteteve sociale

Pershkrimi i programit

Drejtoria e Sherbimeve Sociale ka parashikuar disa aktivitete te cilat korrespondojne me Ditet Nderkombetare te Sensibilizimit per grupe e ceshtje te ndryshme sociale si Dita Nderkombetare e Gruas, Dita Nderkombetare e Romeve, Dita Nderkombetare e Femijeve Jetime, Dita Nderkombetare e te Paaftëve.

Politika e programit

Qellimi i ketij nenprogrami konsiston ne ndergjegjesimin per problemet social-ekonomike te komunitetit e te shtresave ne nevoje qe do jene perfitues te projekteve, perfshirja e aktoreve te ndryshem lokale per te kontribuar ne zbutjen e problematikave te ndryshme, perfshirja ne keto aktivitete e veprimtarive kreative-argetuese.

Njësitë shpenzuese

- Bashkia Berat
- Donatore
- PNUD (Romet)

Objektivat e programit

- Sensibilizimi permes botimit te broshurave, fletpalosjeve, materialeve ndergjegjesuese
- Trajnime, work-shope lidhur me ceshtje te drejtave te gruas e femijeve
- Sensibilizim masiv permes njoftimeve/programeve televizive, banerave etj.
- Mbeshtetje e aktivitetit te fundvitit per femijet jetime.



Bashkia Berat

- Integrimi i komunitetit rom ne shoqeri 2018 – 2020.

E.Mbeshtetja per femije me probleme te renda sociale, te paregjistruar, jetime e te braktisur

Pershkrimi i programit

Ky program synon te mbeshtese femije, familjet e te cileve ndodhen ne gjendje ekonomike te varferise ekstreme, femije te parregjistruar, endacake, te braktisur te cilet mund te perbejne kontigjent per fenomene te rrezikshme si trafikimi etj. Keta femije dhe familjet e tyre (nese kane), do te mbeshteten me paketa ushqimore si dhe do te synohet tu plotesohen nevojat e emergjences per ushqim , veshmbathje qofte edhe per periudhen ne te cilen mund te strehoen ne qendra pritese.

Politika e programit

Ky program konsiston ne trajtimin e rasteve per femijet ne risk etj dhe te mundesoj venien ne rrugen e zgjidhjes te te gjitha problemeve qe hasen ne kete grup femijesh.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e programit

- Mbeshtetja dhe trajtimi i femijeve, familjet e te cileve jane ne gjendje te varferise ekstreme, te femijeve te parregjistruar endacake, te braktisur.
- Asistimi prane rasteve te tilla dhe prane insitucioneve juridike .

F.Strategjia dhe politikat per Barazine Gjinore

Pershkrimi i Programit

Ne zbatim te Ligjit Nr 9970 date 24.07.2008 “Per barazine gjinore ne shoqeri” dhe ne kuader te projektit “Barazi ne qeverisje” u nenshkrua mareveshja e bashkepunimit “Per zhvillimin e Planit te Veprimit Gjinor “ dhe u caktua specialisti dhe grupi i punes qe do te ndjeke zbatimin e gjitha akteve. Pjese te mareveshjes jane perfshire ne Planin Strategjik te Bashkise Berat me kendveshtrimin gjinor te tij.

Politika e programit

Ngritja e nje komisioni te Shanseve te barabarta ne perberjen e e Keshillit Bashkiak me balance gjinore.



Bashkia Berat

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e programit

- Hartimi i kater dokumentave te rendesishem :
 - Dokumenti Gjiner – Shtojce per Planin Strategjik te Zhvillimit.
 - Raporti i Hartzimit dhe rekomandimeve per krijimin e Statistikave Vendore me Baze Gjimore.
 - Plani i Komunikimit.
 - Plani Konkret i Veprimit per Barazine Gjimore

G.Fuqizimi e modernizimi i Qendrave Rezidenciale

Pershkrimi i programit

Ne bashkine Berat funksionojne 2 qendra rezidenciale per persona me aftesi te kufizuar dhe qender ditore me 41 kliente rezident e 20 femije ditor. Ne keto qendra ofrohen sherbime per riaftesimin fizik, psikik dhe edukativ te klienteve.

Politika e programit

Ngritja e kapaciteteve per te perballuar kerkesat. Rritja e sherbimeve dhe kualifikimi i punonjesve qe u sherbejne personave te paafte kliente te qendrave.Rikonstruksione te ndertesave ekzistuese.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e programit

- Sherbimet e ofruara per klientet kane per qellim riaftesimin psiko- socio-edukativ te standartizuar, per nje jetese te pavarur ose autonome per personat me aftesi te kufizuar mendore e fizike.
- Sherbimin ortofonik dhe logopedik qe synon permiresimin e komunikimit te klienteve
- Sherbimi i fizioterapise per riaftesimin psiko-motor te klienteve me aftesi te kufizuar fizike.
- Sherbimi i ergoterapise nepermjet mini-projekteve te organizuara nga edukatoret dhe klientet e Qendres.
- Sherbimi mjekesor nepermjet mjekut me part-time dhe infermierit me kohe te plote.
- Sherbimi administrative nepermjet personelit ndihmes.



Bashkia Berat

H.Funksionimi e gjallerimi i Qendres Komunitare.

Pershkrimi i programit

Ne bashkine Berat funksionon Qendra komunitare e ndertuar nga PNUD me fonde te BE ne kuader te projektit SIRECC per komunitetet rom e egjyptian. Ne kete qender ofrohen sherbime stomatologjike, ambjente per kopesht per femijet, qender shendetesore si dhe salla komunitare.

Politika e programit

Funksionimi i qendres, frekuentimi i saj nga komuniteti ne organizimin e eventeve, funksionimi i kopeshtit per femije dhe venia ne pune e laboratorit stomatologjik.

Njesite shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatoret**

Objektivat e Programit

- Sherbimet e ofruara nga laboratorit stomatologjik do te rrisin higjenen e kulturen shendetesore te femijve e te pjestareve te komunitetit.
- Edukimi i femijve nepermjet frekuentimit te kopeshtit.
- Organizimi i takimeve dhe eventeve ne sallen komunitare.
- Sensibilizimi i familjeve rrom per kujdesin ndaj nenes e femijes si dhe te higjenes ne familje dhe ambientet ku banojne nepermjet vullnetareve dhe qendres shendetesore.

Trajtimi financiar i personave me aftesi te kufizuar ne Qendren “Lira” Berat.

Pershkrimi i Programit

Ky program ka per qellim te ndihmoj personat me aftesi te kufizuar. Ne Qendren “Lira” Berat, trajtohen gjithsej 34 persona (femije adoleshente dhe te ritur), me aftesi te kufizuar.

Per nga ofrimi i sherbimeve Qendra “Lira” eshte e vetmja ne llojin e saj ne Shqiperi pasi ne te jane krijuar 3 alternativa sherbimi.

Qendra rezidenciale:

Eshte krijuar si alternative per ti ardhur ne ndihme 14 personave me aftesi te kufizuar, te cilet nuk jane ne gjendje te jetojne ne menyre te pavarur per shkak te veshtiresive mendore apo fizike.

Apartamentet e mbrojtura ofrojne organizimin e nje jete familjare me 2 (dy) grupe banesash ku secili grup eshte i mbikqyrur dhe kujdesen edukatoret dhe specialistet perkates. Cdo i ri eshte pjese aktive e grupit sipas mundesive dhe veshtiresive qe paraqet. Ketu afrohet sistemi per te rinj i te 2 (dy) gjinive qe i perkasin grupmoshes 18-35 vjec te cilet duke u mbeshtetur ne aftesite e tyre dhe me ndihmen e edukatoreve perpiqen te jene sa me autonom ne menyren e organizimit te jetes Veprimtarite qe ofron kjo qender realizohen ne nje mjedis pozitiv, stimulus dhe te sigurt.



Bashkia Berat

Atelie pune:

Ne shoqerine tone puna perben nje element shume te rendesishem per ti dhene me shume vlera strukturimit te nje personi adult. Duke krijuar mundesi pune dhe okupacioni te adaptuar per personat me aftesi te kufizuar institucioni kontribon ne integrimin e tyre social dhe i ndihmon ata qe te zhvillojne kapacitetet e tyre fizike, psikike.

Qendra ofron sherbime ne 4(kater) atelie: kreativitet, lavanteri, kuzhine dhe kopshtari. Ateliete mbeshtesin te rinjte mbi principin qe puna perben celesin per ti dhene me shume vlere nje personi, per socializimin e tij dhe nje mbeshtetje esenciale ne zhvillimin psikik, mendor dhe fizik, Per cdo person percaktohet nje plan inkadrimi i cili eshte punuar duke implikuar te gjitha organizmat e perfshira, prinderit, specialistet, edukatoret, infermierin etj. Ky plan merr parasysh pritshmerite individuale te personit mundesite dhe limitet e tij. Ai percakton objektivat afatgjata dhe rruget qe duhen ndjekur.

Qender ditore:

Ofron sherbim te planifikuar per persona me aftesi te kufizuar qe vijne nga komuniteti me afat te percaktuar kohor. Kapaciteti i plote i qendres eshte 20 persona nga mosha 5-30 vjec. Trajtimi dhe sherbimi qe i ofrohet kesaj kategorie eshte nga ora 08:00-13:00.

Ndarja e tyre eshte bere duke respektuar moshen dhe shkallen e veshtiresive apo kapaciteteve qe cdo person paraqet. Ofrohen sherbime sipas kompetencave dhe organizohen aktivitete te cilat i pershtaten nevojave te zhvillimit te cdo individi

Grupi i pare eshte quajtur kopeshti pasi trajtohen femije te moshes 3-11 vjec

Grupi i dyte trajton adoleshente 14-18 vjec

Grupi i trete trajton adult 18-30 vjec te cilet pervec programit mesimor edukativ te reduktuar fokusohen me shume ne mini atelie profesionale si robaqepesi, pune dore te ndryshme. Edukatoret e mbeshtesin punen e tyre ne zhvillimin konjitiv te personave dhe ne nderveprim midis njeri-tjetrit ne grup.

Ne qendren ditore ndodhen dhe 2 specialiste logopedisti dhe fizioterapisti.

Logopedisti punon ne menyre individuale me te gjitha personat duke mundesuar zhvillimin e komunikimit tek ta sipas planeve individuale te zhvillimit.

Fizioterapisti punon individualisht me ta per zhvillimin e kapaciteteve motore te cdo person qe paraqet keto veshtiresi.

Qendra ka marre persiper edhe nje vakt drake per personat ditor.

Pranimi i personave ne qendren ditore eshte vleresuar nga specialistet qe perbejne dhe grupin multidisiplinar ku ne te ben pjese dhe prindi.

Kjo qender ka per qellim te ndihmoje personat per tu integruar ne planin social dhe kulturor. Ne te gjitha situatat synohet qe cdo femije ti afrohet nje program kujdesi te hartuar ne menyre individuale, qe ata te kene mundesi te zhvillojne shprehite e tyre dhe te maksimizojne potencialin nepermjet pjesmarrjes ne nje numer veprimtarish ne nje mjedis stimulus, pozitiv dhe te sigurt.



Bashkia Berat

Politika e programit

Kjo qender ka per qellim integrimin e personave me aftesi te kufizuar ne shoqeri. Misioni yne eshte :

Zhvillim, Edukim, Integrim

Prioritet e institucionit:

- Kujdes te vazhdueshem ditor dhe gjate nates/sherbim 24 oresh.
- Ofrim i pese vakteve per rezidencialet dhe ofrimi i dy vakteve per ditoret.
- Sherbime per kryerjen e aktiviteteve ditore ne ateliere perkatese.
- Sherbime kreative , kulturore sociale / integrimi i tyre ne jeten sociale.
- Terapi individuale logopedi dhe fizioterapi
- Terapi zhvillimi ne grup me femijet e vegjel.
- Mini atelie kreativiteti me te rinjte ditor.
- Atelie pune.
- Sherbime edukative per te garantuar ruajtjen dhe rritjen e aftesive fizike, sociale dhe pavarsine individuale.
- Sherbime shendetsore infermierike te programuara ne varesi me nevojat e PAK

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e programit sipas alternativave te sherbimit

Objektivat ne Apartamentet e mbrojtura :

- Te ofroje nje akomodim i cili permbush nevojat e te rinjve me aftesi te kufizua, me qellim sigurimin e nje ambjenti familjar duke favorizuar keshtu dhe zhvillimin e tyre.
- Te ofroje nje mjedis mbeshtetes dhe te sigurt ku femijet dhe te rinjte degjohen dhe inkurajohen per te shprehur nevojat, deshirat dhe ndjenjat e tyre.
- Te nxise besim dhe pavarsi
- Te ofrojne mundesi qe te rinjte te bejne zgjedhje
- Te siguroj nje ambjent familjar duke favorizuar keshtu dhe zhvillimin e tyre
- Te ofroje sherbime te cilat kane ne baze mbikqyrjen e te rinjve dhe qe synojne marrjen e pergjegjesive per organizimin e dites prej tyre.

Objektivat e ateliese se punes :

- Te formoje nje strukture e cila i jep akses botes se punes.
- Ti jap prioritet principit se puna sherben si celes per integrimin ne shoqeri.
- Te hartoje programe individuale te kujdesit,ne drejtim te punesimit, qe te permbushin nevojat e cdo te riu,me qellim qe te jene aktiv dhe te pasurojne vlerat individuale.
- Te adoptoje procese pune te rinjve, te cilet te jene aktiv dhe te pasurojne vlerat individuale.



Bashkia Berat

- Te krijohen bazat e nje mini ekonomie, ku te gjithë te rinjte te shperblehen per punen qe bejne.
- Te sigurohet integrimi i te rinjve ne jeten sociale, te punohet ne bashkepunim me ta.
- Te perdoret puna ne atelie si rruge zhvillimi ne te gjitha fushat e mesimdhenies per personat me aftesi te kufizuar.

Objektivat e Qendres ditore :

- Te ofroje nje mjedis te sigurt dhe te mbeshtese femijen qe te shprehin nevojat, deshirat dhe mendimet e tyre.
- Te punohet ne bashkepunim me prinderit dhe me personat e tjere qe ofrojne sherbime ne qender.
- Te hartoje programe individuale qe permbushin nevojat e cdo femije per tu zhvilluar, kjo ne bashkepunim me prinderit dhe personelin, me qellim qe te ofrohet nje mjedis i sigurt dhe mbeshtetes.
- Te ofroje sherbime te cilat ndihmojne ne zhvillimin e femijes ne te gjitha fushat.
- Te hartoje objektiva per zhvillimin e femijes te cilat do te sigurojne nderhyrjen ne fushen me emergjente te zhvillimit te femijes.
- Te organizoje aktivitete, te ofroje sherbime, te cilat respektojne moshen biologjike te femijes dhe te ritureve.

PROGRAMI I MENAXHIMIT TE PRONAVE TE BASHKISE DHE REGJISTRIMI I TYRE NE Z.V.R.P.P.

Përshkrimi i programit

Ky program ka per qellim rritjen e te ardhurave te bashkise nepermjet nje , menaxhimi sa me te mire te pronave te bashkise, si dhe rritjen e numrit te pronave te regjistruara ne Z.R.P.P.

Politika e programit

Politika e ketij program eshte permiresimi i gjendjes financiare te bashkise nepermjet rritjes se numrit te ambjenteve te dhena me qira ose kontrata te tjera si dhe monitorim sa me efikas i tyre.

Njesite shpenzuese

- Bashkia Berat

Objektivat e programit

- Menaxhimi i 304 njesive te tregut Industrial, dhe menaxhimi i tregut te “Fruta perimeve” Morave.
- Menaxhim i pronave te dhena me qira .
- Regjistrimi ne Z.R.P. P i pronave te bashkise.



Bashkia Berat

Produkte :

- Te ardhurat nga Tregu Industrial i Lagjes “ 30 Vjetori ” per vitet 2017 , 2018, 2019 do te jenë përkatësisht 14,548,464 lekë.

- Te ardhurat nga dhënia me qira e pronave

Për vitin 2018 do të jetë 3,000,000 lekë

Për vitin 2019 do të jenë 3,060,000 lekë

Per vitin 2020 do te jenë 3,121 ,200 lekë

- Regjistrimi në Z.V.R.P.P

Për vitin 2017 të 120 pronave .

Për vitin 2018 të 150 pronave.

Për vitin 2019 të 160 pronave .

- Shpenzimet e regjistrimit të pronave

Për vitin 2017 do të jenë 720,000 lekë.

Për vitin 2018 do të jenë 900,000 lekë.

Për vitin 2019 do të jenë 960,000 lekë.

PROGRAMI I STREHIMIT DHE MENAXHIMIT TE BANESAVE SOCIALE ME QERA

Pershkrimi i programit

Ky program ka per qellim ti vije ne ndihme familjeve ne nevojë per subvencionim e qerave per keto familje sipas nenit 24 te Ligjit nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”, ndertimin e nje pallati me 24 apartamente me bashkefinancues Entin Kombetar te Banesave, duke kontribuar me truallin qe do te perdoret per ndertimin e ketij objekti, vazhdim i pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura zbatuar nga M.P.P.T.

Politika e programit

Politika e ketij programi konsiston ne ardhjen ne ndihme te familjeve ne nevojë si nepermjet dhenies se bonusit te strehimit per subvencionin e qerave t e familjeve ne nevojë, pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura” zbatuar nga M.P.P.T

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Enti Kombetar i Banesave**

Objektivat e programit

- Ndertimi i banesave ne ndihme te familjeve ne nevojë.
- Menaxhimi i 48 apatameneve te banesave sociale me qera.



Bashkia Berat

- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojme bonus strehimi.
- Perfshirja ne skeme e familjeve të strehuara në banesat sociale qe perfitojme subvencionim te qirasë.
- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojne nga subvensioni i i kredive me interes te zbutur, projekt i zbatuar nga M.P.P.T.

Produkte te programit :

Te ardhurat nga banesat sociale për vitin 2018 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga banesat sociale për viti 2019 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga banesat sociale për viti 2020 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit për vitin 2018 ne shumën 308,820 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit për viti 2019 ne shumën 314,996 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit viti 2020 ne shumën 321,296 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2018 do te jenë 250,000 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2019 do te jenë 300,000 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2020 do te jenë 350,000 lekë .

Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2018 ,2019, 2020 do te jete per cdo vit ne në vlerën 58,770 € nga të cilat 31,770 € do te shlyhet nga fondet e bashkise dhe 27,000 € do te shlyhen nga fondi i banesave sociale.

Përfshirja në skeme për bonus strehimi për familjet e pastreha me ta ardhura familjare mujore shume te uleta do te jete :

Per vitin 2018 ne vleren 200,000 leke .

Per vitin 2019 ne vleren 204,000 leke .

Per vitin 2020 ne vleren 208,080 leke .

Perfshirja ne skeme e familjeve të strehuara në banesat sociale qe perfitojme subvencionim te qirasë.

Per vitin 2018 ne vleren 1,200,000 leke .

Per vitin 2019 ne vleren 1,224,000 leke .

Per vitin 2020 ne vleren 1,248,480 leke .

b. Pastrimi

Përshkrimi i Programit

Programi i shërbimit të Pastrimit parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet. Shtrirja e këtij shërbimi edhe ne njesite administrative te bashkise se re..

Politika e Programit

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti,



Bashkia Berat

si dhe në ambientet ku qytetarët të shlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla etj.)

Njësia Shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Sipërmarrja e pastrimit**
- **Buxheti i Shtetit**

Objektivat e Programit

- Pastrimin e Rrugëve dhe Shesheve kryesore të qytetit për tu krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike).
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike) si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore në standarde që kërkon koha.
- Larja dhe lagja e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
- Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimit të mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
- Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevralgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj..)

Produktet që synohen të ofrohen

1. Pastrimi i Rrugëve

- Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.

2. Mirëmbajtja e Ambienteve Publike

- Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen blloqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.

3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane

- Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.

4. Grumbullim – transportim i mbetjeve inerte (ndërtimore)

- Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.



Bashkia Berat

5. Larje dhe lagje e rrugëve

- Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagje të rrugëve kryesore gjatë sezonit Prill-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

6. Dizinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi

- Dizinfektimin, deratizimin, dizinsektimin e ambienteve publike për të pasur një ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

7. Mirëmbajtja e Vend-Depozitimit të mbetjeve urbane

- Kavaletimi i mbetjeve urbane në vend depozitime për krijimin e kushteve sa më të mira ambientale për mbrojtjen nga vetëdëzja dhe zjarret e mundshme.

8. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit

- Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

c. Gjelberimi

Pershkrimi i Programit

Programi “Gjelberimi,” konsiston në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelberta duke kryer të gjitha proceset teknologjike të punës për mirëmbajtjen e sipërfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure të gjelber, mbjellja e pemëve dekorative etj.

Shtim të sipërfaqeve të gjelberta, duke synuar mobilimin e gjelber të çdo rruge, sheshi dhe shtimin e parqeve për fëmijet, si një dekor edukues dhe atraktiv për qytetin dhe qytetarët.

Politika e Programit

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve mjedisore sa më të këndshme dhe funksionale, brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti shlodhës dhe qetësie ku qytetarët të kalojnë një pjesë të kohës së tyre, duke nderhyrë edhe në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti.

Njësia Shpenzuese:

- Bashkia Berat
- Ndermarja e Gjëlberimit

Objektivat e Programit

- ❖ Mirëmbajtjen e struktureve të sipërfaqeve të gjelberta duke kryer të gjitha proceset teknologjike të punës për mirëmbajtjen e sipërfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure të gjelber.
- ❖ Shtimi i sipërfaqeve të gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, sip, me bar, mbjellja e pemëve dekorative etj.
- ❖ Mirëmbajtja e sistemit të rrugicave dhe shesheve të pushimit në lulishten e qendres..



Bashkia Berat

- ❖ Reabilitimi i sistemit të ujitjes në lulishten e rruges hyrese të Beratit.
- ❖ Mirembajtja e Tendave dhe i pjergullave.
- ❖ Kompletimi me stola dhe tavolina për të krijuar vende shpłodhje për qytetarët.
- ❖ Sistemim i gjelbert i bankinave të lumit “Osum”

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Mirëmbajtje e strukturese të gjelbert në qytetin e Beratit:

- Kryerjen e të gjitha proceset teknologjike të punës si në një sipërfaqe prej 79 274 m².siperqafe rruge dhe sheshe 15 331 m², sip. me bar dekorativ 57 486 m², sip. me lule sezonale 3 748 m², drure zbukuruese rrugore 5 600 rrenje, gardh i gjelbert 1 120 ml, tunel i gjelbert 50 ml.
- Kompletimi me stola dhe tavolina për të krijuar vende shpłodhje për qytetarët.
- Mirembajtjen e 14 tendave të gjelberta dhe 10 qoshka dekorative, kangjella dekorative 2 112 ml,
- Mirëmbajtje e gjithë inventarit të pershire në siperfjet e gjelberta si, stola, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash për fëmijë, e kende arhetuese për moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.
- Mbjellje të reja të drurëve dhe shkurreve në rrugë të lulishte dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelberta.

d. Mirembajtja e varrezave publike, varrezave të dëshmoreve dhe dekorit të qytetit.

Njësia Shpenzuese

- Bashkia Berat
- Sipermarja e shërbimit

Mirëmbajtje e sipërfaqeve dhe parcelave në varrezat publike dhe të dëshmorëve, sipas volumeve të përcaktuara në preventivin e kontratës së sipërmarrjes dhe mirëmbajtja e dekorit të qytetit, për festat zyrtare dhe sipas programeve të Bashkisë.

Nevoja për zgjerim dhe investim në varrezat publike.

PROGRAMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITARE DHE EDUKIMIT

- Shërbimi arsimor në Bashkinë Berat

Arsimi parashkollor

Në të gjithë territorin e Bashkisë Berat ndodhen **46 kopshte**, nga të cilat 26 janë ndërtesa të reja dhe 20 kërkojnë riparime.

Në qytetin e Beratit shërbejnë **14 kopshte**, janë të vendosura në pjesën jug- perëndimore të qytetit. Në pjesën tjetër të qytetit, mungon ky shërbim.



Bashkia Berat

Sinja përbëhet nga 14 fshatra, nga të cilat vetëm 7 ofrojnë shërbimin e kopshteve. Velabisht përbëhet nga 13 fshatra, 11 prej tyre kanë nga një kopësht.

Njësia Otlak e siguron këtë shërbim në 8 fshatra nga 11.

Njësia Roshnik është njësia e cila ka numrin më të vogël të kopshteve që shërbejnë, 3 dhe numrin më të madh të fshatrave që nuk e sigurojnë këtë shërbim.

Nga 46 kopshte vetëm 9 plotësojnë standartet e projektimit 18m²-25m²/fëmijë. Nga të cilat 3 ndodhen në Berat, 1 në Sinjë, 2 në Roshnik dhe 3 në Velabisht. Njësia Otlak nuk ka asnjë kopësht që plotëson standartet e projektimit.

Arsim 9 vjeçar

Në Bashkinë Berat shërbejnë 43 shkolla 9 vjeçare, 27 prej tyre janë ndërtesa të reja dhe 16 kërkojnë riparime.

Njësia Otlak dhe Velabisht sigurojnë mbulimin e 80 % të territorit me këtë shërbim. Njësia Sinjë lë jashtë rrezes së mbulimit 6 fshatra. Në Roshnik, 4 fshatra nuk sigurojnë shërbimin me shkolla 9 vjeçare.

Nga 43 shkolla që shërbejnë në Bashkinë Berat, vetëm 1 plotëson standartet e projektimit 20m²-25m². Kjo shkollë ndodhet në njësinë Velabisht (20.9m²/fëmijë).

Arsim i mesëm

Në Bashkinë e Beratit shërbejnë 11 shkolla të mesme, 7 ndodhen në qytetin e Beratit prej të cilave 3 janë shkolla të mesme profesionale. Njësitë e tjera kanë nga një shkollë të mesme. 9 prej ndërtesave janë të reja dhe 2 janë të amortizuara.

Berati mbulon me këtë shërbim rreth 80% të territorit. Njësia Velabisht dhe Sinjë mbulojnë vetëm 40 % të territorit. Otlaku dhe Roshniku mbulojnë me këtë shërbim 50% të territorit.

Tabela 16. Hapësirat arsimore të njësive dhe standartet e projektimit

Niveli i arsimit	Standartet e projektimit	Berat	Velabisht	Otlak	Sinjë	Roshnik
Kopësht	18m ² /fëmijë	7.3m ² /fëmijë	12.34m ² /fëmijë	3.8m ² /fëmijë	12.3m ² /fëmijë	13.1m ² /fëmijë
9 vjeçar	20m ² -25m ² /fëmijë	1.5m ² /fëmijë	4.30m ² /fëmijë	2.24m ² /fëmijë	4.36m ² /fëmijë	3.9m ² /fëmijë
I mesëm	20m ² -23m ² /fëmijë	3.05m ² /fëmijë	4.32m ² /fëmijë	3.50m ² /fëmijë	4.17m ² /fëmijë	4.81m ² /fëmijë



Bashkia Berat

Përshkrimi i programit

Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit parashikon veprimtarine ekonomike,financiare dhe ate te sherbimit ne mirembajtjen e kopshteve,cerdheve dhe shkollave 9-te vjecare,te mesme te pergjithshme dhe profesionale qe jane brenda teritorrit dhe juridiksionit te Bashkise Berat.

Politika e programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e kushteve optimale per mirerritjen e femijeve te moshes(0-3 vjec) per cerdhet dhe (3-6 vjec) per kopshtet si dhe sigurimin e nje infrastrukture arsimore bashkekohore per nxenesit.

Njësia Shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Qendra Ekonomike e Arsimit**
- **Buxheti i shtetit**

Objektivat e programit

- Permbushjen me sukses e te gjitha detyrimeve ligjore ne fushen e arsimit.
- Synimi i permbushjes se standarteve te miratuara nga M.A.SH ne Strategjine e Arsimit.
- Permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit.
 - Te realizoje mirembajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave te qytetit , duke synuar ne pambushjen e standarteve optimale, duke vleresuar si si fushe prioritare:
- 4. Rikonstuksion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Nj.A.Velabisht. (me fonde te buxhetit te shtetit)
- 5. Rikonstrukcion i Kopshteve nr.1,2,3.
- 6. Rikonstrukcion Cerdhja nr.7 .
- Kompletimin e cerdheve me pajisje te reja, per shkak te amortizimit te pajisjeve ekzistuese.

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Materiale zyre e te pergjithshme

Ketu perfshihen te gjitha materialet per pastrim, disifektim, ngrohje e gatim per nevojat e kopshteve, cerdheve, shkollave, konviktit dhe administrates se qendres ekonomike.

2. Materiale dhe sherbime te tjera special

Perfshihen te gjitha ato materiale si: uniforma dhe veshje speciale, ushqimet e femijeve, ilace



Bashkia Berat

mjekësore si dhe të tjera materiale dhe shërbime speciale për nevojat e kopshteve, cerdheve, konvikteve dhe shkollave të qytetit.

3. Shërbime nga të tjerë

Përfshihen të gjitha shpenzimet për energji elektrike, ujë dhe pipë dhe telefon për të gjitha institucionet e arsimit parashkollor, 9-të vjeçar, të mesëm të përgjithshëm e profesional si dhe të cerdheve.

4. Shpenzime transporti

Përfshihen shpenzimet për transportin e ushqimeve të kopshteve, cerdheve dhe konvikteve të qytetit.

5. Mirembajtje të zakonshme

Përfshihen të gjitha materialet për mirembajtje të ndryshme, riparime e lyerjen e objekteve arsimore.

6. Shpenzime të tjera operative

Programi Strategjik O5P4: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë administrative të Bashkisë Berat.

Projektet:

1. Rikonstruktion i shkollës 9 vjeçare në fshatin Veternik, Velabisht.

2. Rikonstruktion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Velabisht.

3. Rikonstruktion i shkollës së mesme dhe ndërtimi i ambjenteve sportive në fshatin Sinjë, Sinjë.

a. Kultura (Qendra kosto)

Përshkrimi i programit

Programi i Kulturës do të tentojë të japë një hapësirë edhe me të plotë jetës artistike dhe kulturore të qytetit jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e metejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë për qytetin e Beratit, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative të cilat vijnë pranë Qendres Kulturore e Bashkisë Berat nga persona të tjerë, shoqëria civile apo ente të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit që ka do të bente jo vetëm për qytetarin e Beratit, por edhe turistin dhe vizituesin e tij, me atraktiv.

Disa vlera kulturore të Qytetit tona që vlejnë të përmenden.

Kalaja e Beratit është shpallur monument kulture që në vitin 1948 (ligji nr 609 datë. 24/05/1948). Më pas kjo hapësirë është zgjeruar në qendrën historike të sotshme të Beratit e përbërë nga tre lagjet, e Goricës, Mangalemit dhe Kalasë, të shpallura zonë e trashëgimisë kulturore botërore me datë 31.03.2009ⁱⁱⁱ. Vendimi i UNESCO-s cakton sipërfaqet e tyre si dhe një zonë mbrojtëse të shtrirë përreth tyre. Pjesa veri-perëndimore dhe jugore nuk lejojnë asnjë ndërtim, ndërsa pjesa lindore fushore dhe kodrinore kanë kufizime në densitet,



Bashkia Berat

lartësi, dhe stil arkitektonik. Gjithashtu, në Bashkinë e Beratit ndodhen edhe 86 monumente kulture të kategorisë së parë dhe 363 monumente kulture të kategorisë së dytë^{iv} të cilat administrohen sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Neni 32 i ligjit të mësipërm specifikon që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndaloher çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me Vendim të KKT nr. 1, datë 09.09.2015 Kisha e Shën Mërisë në Sinjë është shpallur zonë e rëndësisë kombëtare në planifikim.

Politika e Programit:

Politika e këtij programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin e Beratit duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale që bashkëjetojnë në Berat dhe promovimin e një qyteti sa më tërheqës dhe konkurrues për tregun e biznesit dhe të vizitorëve.

Njësitë shpenzuese:

- **Bashkia Berat**
- **Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”**
- **Donatore**

Objektivat e politikës së programit:

- 1- Ritja e cilesise se shfaqeve artistike qe jepen nga institucioni.
Kjo pike arrihet nepermjet ngritjes se nje komisioni i perbere nga profesionista te fushes artistike dhe kulturore te cilet gjykojne cilesine e projektit artistik
- 2- Ringritja e teatrit
Ky objektiv do te realizohet nepermjet implementimit te ideve qe ka regjisori i cili eshte i specializuar kryesishte ne fushen e teatrit .
- 3- Kalimi i Qendres Kulturore Margarita Tutulani ne nje atraksion turistik te vizitushem.
Realizimi i ketije objektivi do te behet duke krijuar ambjente te pershtatshme per te qen ne atraksion turistik nepermjet ngritjes se muzeut historik dhe vendosjen e ambjenteve te galerise se Arteve ne dispozicion te turistave qe vizitojne qytetin
- 4- Ringritja e muzeut Historik Qendra Kulturore Margarita Tutulani disponon ne inventar objekte te muzeut historik te cilat mund ti shfrytetoje ne aritjen e ketije objektivi
Pervec kesaj te fundit objektivi tjeter eshte edhe pasurimi me sa me shume objekte qe kane vlere historike duke bashkepunuar edhe me institucione te tjera te se njejtes fushe .

Risite:

Nje nga risite qe ne parashikojme gjate ketyre viteve (2018-2019-2020-) eshte krijimi i nje brand-book i cili te kete ne perberje jo vetem historikun dhe pamje te pallatit te Kultures nder vite por edhe krijimin e nje logo-je identifikuese per institucionin kete mendojme ta realizojme brenda vitit 2017.



Bashkia Berat

b. Galeria e Arteve "Eduard Lear" (qendra kosto)

Përshkrimi i programit

Programi parashikon permiresimin e metejshe me te galerise se arteve jo vetem ne drejtimte aktiviteteteve dhe shtimit te tyre sasior por per ta mbeshtetur me investime per krijimin e e ambjenteve me te kompletuara e bashkekohore. Rritja e fondit te galerise me vepra te autoreve te rinj.

Politika e Programit

Politika e këtij programi synon gjallerimin e jetes rinore dhe kulturore ne qytet nepermjet zhvillimit te aktiviteteteve te programuara vit pas viti duke krijuar mundesi reale per zgjerimin e saj si ne fushen e pjesmarresve e vizitoreve ashtu dhe ne vlerat kulturore qe mbart fondi i saj.

- **Bashkia Berat**
- **Galeria e Arteve “ Edward Lear”**
- Donatore**

Objektivat e politikës së programit

- ❖ Shtimin e fondit te Galerise.
- ❖ Krijimin e hapësirave te nevojshme dhe te mjaftueshme per ruajtjen mirembajtjen dhe ekspozimin e fondit te saj.
- ❖ Evidentimin e talenteve te reja ne piktore e skulpture e per tradite dhe ne artizanat..
Promovimin dhe shtimin e numrit te vizitoreve duke e kthyer ate nje pike te rendesishme te axhentes turistike ne qytet.

Produktet që synohen të ofrohen

1. Shtimi dhe ruajtja e mirembajtja e fondit te galerise
2. Realizimi i listes se aktiviteteteve dhe zgjerimi i saj mbi bazen e kapaciteteve financiare te nevojshme dhe te mjaftueshme qe do te krijohen.
3. Zgjerimi dhe kompletimi i ambjenteve ne funksion te krijimit te kushteve bashkohore.

c. Biblioteka "Vexhi Buharaja" (qendra kosto)

Përshkrimi i programit

Programi i Bibliotekes parashikon rritjen e fondit te bibliotekes, mirembajtjen e tyre, dhe shtimin e numrit te lexuesve per te gjithë grupmoshat.

Politika e Programit



Bashkia Berat

Politika e këtij programi synon shtimin e fondit të materialeve të bibliotekës, zhvillimin e aktiviteteve promovuese e nxitese në funksion të shtimit të lexuesve e kryesisht atyre të rinj në funksion të promovimit të kultures dhe edukimit.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Bibiloteka “Vexhi Buharaja”**
- **Donatore**

Objektivat e politikës së programit

- Shtimi i numrit të fondit të librave për të gjithë grup moshat.
- Rritja e numrit të lexuesve dhe shumëllojshmërisë së librave të lexuara prej tyre.
- Promovimi i veprave dhe autoreve të ndryshëm e kryesisht atyre vendas.
- Bashkëpunimi me shkollat e mesme në funksion të gjallërimit të jetës në funksion të zhvillimit të aktiviteteve rinore për librin, poezinë etj.
- Ngritja e një librarie multimediale (mediateke online).

Produktet që synohen të ofrohen

1. Ruajtja e mirëmbajtja e fondit të bibliotekës në numër dhe shtimi i tij duke e pasuruar me libra e materiale të tjera të nevojshme për të gjithë grup moshat.
2. Organizimi i aktiviteteve rinore që nxisin kulturën e të lexuarit.
3. Ofrimi i mundësive, që lexuesit e rinj në mënyrë online të lexojë koleksionin e veprave të bibliotekës.

d. Turizmi

Pershkrimi i programit

Angazhimi i Bashkisë për zhvillimin e turizmit, për ta shndërruar qytetin në një destinacion cilësor, të zhvilluar mbi parimet e qëndrueshmërisë.

Politika e Programit

Programi mbështetet në parimet e CILËSISË dhe QËNDRUESHMËRISË – cilësia dhe vlerat mbështetur në eksperiencën e vizitorëve; produktet dhe shërbimet me cilësi që paraqesin vlerën unike të Beratit; në harmoni me mjedisin; dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët e Beratit – këto gjëra, së bashku, do të sigurojnë qëndrueshmërinë e turizmit në Berat.



Bashkia Berat

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e politikës së programit

- Te arrihet që Berati të jetë një destinacion i njohur, mbështetur në trashëgiminë kulturore natyrore dhe shpirtërore, duke ofruar shërbime dhe eksperiencë unike në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të arrihet një zhvillim i harmonizuar dhe afatgjatë i turizmit, mbështetur në parimet e qëndrueshmërisë.
- Të arrihet një jetë më e mirë ekonomike dhe shoqërore për qytetarët e Beratit, duke ofruar mundësi punësimi dhe rritje të të ardhurave përmes zhvillimit të turizmit.

Produktet që synohen të ofrohen

1. Mbrojtja dhe të përmirësimi i objekteve kulturore në Qendrën Historike.
2. Mbrojtja dhe të përmirësimi i objekteve natyrore.
3. Zhvillimi i një pakete promociionale e cila të jetë me cilësi bashkëkohore europiane
4. Zhvillimi i aktiviteteve të Drejtorisë së Kulturës konkretisht aktivitete për turizmin.
5. Pjesë e Bashkisë janë edhe njësitë administrative do ishte shumë mire për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin ekonomik të vendit identifikimi prodhimeve agro, vendosja e tyre në harte, dhe pse jo zhvillimi i fermave në trajtë tregu (mundësia e promovimit të tyre nga vizitorë vendas dhe të huaj).
6. Risi në qytetin e Beratit është eksplorimi i qytetit me biçikleta (Ecja me biçikleta)
7. Pjesë mjaftë e rëndësishme e zhvillimit i tregut të artizanatit, mundësi shumë e mire promovimi vlera dhe përdyshim rritje e ekonomisë.
8. Zhvillimi i bizneseve në interes të turizmit, marketingut.
9. Krijimi i tureve lokale.
10. Përmirësimi i kapaciteteve të restoranteve duke i shërbyer turistëve të huaj.
11. Identifikimi dhe rritja e kërkesave për suvenire.
12. Promovimi i kuzhinës tradicionale të Beratit.
13. Rritja e vizibilitetit të Beratit si një destinacion turistik përmes pjesëmarrjes në promovimin e aktiviteteve të rëndësishme.
14. Nxjerrja e një 'Marke' për Beratin dhe zhvillimi i paketave turistike.
15. Zhvillimi dhe promovimi i SME-ve në agrobiznes dhe agroturizëm.
16. Përgatitja dhe lehtësimi i logjistikës për operatorët turistikë dhe vizitorët.
17. Zhvillimi i disa aktiviteteve gjatë vitit në interes të qytetarëve Beratas, dhe turistëve vendas dhe të huaj



Bashkia Berat

e. Trashëgimia Kulturore dhe Artet

Përshkrimi i programit

Ruajtja dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore në Berat, si një aset universal për zhvillim kulturor, social dhe ekonomik.

Politika e Programit

Qëllimi i përgjithshëm i punës është ruajtja, përmirësimi, promovimi i trashëgimisë botërore së prekshme dhe të paprekshme në Bashkinë Berat, në shërbim të komunitetit të qytetit dhe atij kombëtar dhe ndërkombëtar.

- **Bashkia Berat**
- **Donatore**

Objektivat e politikës së programit

- Zhvillimin e projekteve që kanë si qëllim përfitimin kulturor, ekonomik dhe social të banorëve të qytetit të Beratit nga trashëgimia kulturore.
- Bashkëmenaxhimi dhe monitorimi i trashëgimisë kulturore Beratsipas kritereve dhe udhëzimeve të përshkruara nga UNESCO.
- Ruajtja, promovimi dhe nxitja e traditave të artizanatit. Zhvillimin e aftësive të artizanëve beratas për të ruajtura dhe zhvilluar aftësitë e tyre për të përfituar nga zejet e vjetra.
- Zhvillimi i projekteve të cilat kanë si qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore.
- Promovimi i trashëgimisë në arenën ndërkombëtare dhe krijimin i lidhjeve me partnerë të ngjashëm Evropian për të mundësuar dialog dhe bashkëpunim kulturor ndërmjet qytetarëve.
- Koordinim për krijimin dhe aplikimin e projekteve të cilat synojnë të rehabilitojnë dhe restaurojnë monumentet e kulturës.
- Zhvillimi i arteve tradicionale në pikturë, zeje, muzikë dhe valle. Krijimi dhe rritja e cilësisë së festivaleve tradicionale popullore

Produktet që synohen të ofrohen

- Krijimi i Manualit për mirëmbajtjen dhe restaurimin si dhe përdorimin e shtëpive karakteristike në interes të turizmit – 500.000 leke
- Krijimi dhe implementimi i strategjisë për zhvillimin e shtëpive të pabanuara. Pilotimi i projektit në një shtëpi të braktisur. 3.000.000 leke
- Krijimi i Qendrës e Trashëgimisë Botërore. 10.000.000 leke
- Vendosja e Indikatorëve përshkrues dhe përditësimi i tyre.
- Ndërtimi i Qendrës së Artizantit. – 1.500.000 leke
- Krijimi i Kampit “Gurskalitësit e Beratit”. 400.000 leke.
- Risetimi i Festivalit Popullor “Trinkat e Beratit”. 500.000 leke



Bashkia Berat

- Prania në Rrjete Ndërkombëtare të Trashëgimisë Kulturore (Europa Nostra; Rrjeti i Siteve të Trashëgimisë Botërore). 300.000 leke
- Organizimi i Panairit Kombëtar të Artizanatit. 400.000 leke
- Krijimi i Kampeve Komunitare Ndërsiplinare të Restaurimit të Monumenteve. 3000.000 leke
- Identifikimi, dokumentimi i shkruar, audio dhe video i arteve tradicionale. 500.000 leke

ë. Marrëdhëniet me Jashtë

Përshkrimi i programit

Gjetja e burimeve alternative të financimit për projektet e Bashkisë Berat dhe plotësimi shpeshherë i bashkëfinancimit me burimet njerëzore të Bashkisë.

Politika e Programit

Politika e këtij programi synon të koordinojë marrëdhëniet dhe projektet me institucione dhe partnere ndërkombetare dhe të ndjeke veprimtarinë me jashtë të administratës së Bashkisë Berat.

- **Bashkia Berat**
- **Partnere Nderkombetare**

Objektivat e politikës së programit

- Te negocioje dhe krijojë partneritetet me organizata, donatore dhe aktore ndërkombetare , për mbështetjen e projekteve bilaterale
- Te nxisë bashkëpunimet me bashkitë dhe komunat binjake të qytetit , për të aplikuar projekte të përbashkëta në fusha të ndryshme, dhe të kërkojë për lidhje të reja në fushën e binjakezimit midis institucioneve të qeverisjes vendore.
- Te kujdeset për hartimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Europian.
- Te organizojë veprimtarinë me jashtë të administratës së bashkisë
- Te nxisë dhe bashkëpunojë për promocionin e qytetit në fushën ndërkombetare.

Produktet që synohen të ofrohen

Bashkia Berat ka punuar intensivisht për gjetjen e burimeve alternative të financimit të projekteve të saj. Është punuar për të aplikuar për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj dhe do të vazhdojmë me intensitet kontaktet dhe bashkëpunimin me :

- ✓ Bashkitë Binjake
- ✓ Rrjetet Ndërkombëtare
- ✓ Organizatat dhe donatorë
- ✓ Projektet e Bashkimit Europian.



Bashkia Berat

Gjatë vitit 2017 janë duke realizuar:

- ✓ Projekti me Banken Botërore, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Turizmit për Shqipërinë e Jugut, pas ratifikimit të Marrëveshjes në Parlamentin Shqiptar, pritet të fillojë në Qershor 2017 dy investime të rëndësishme në qytet:

1- Rehabilitimi i rrugës automobilistike “Muzak Topia” për në Kala.

2- Rehabilitimi i rrugës me kalldrëm për këmbësoret “Mihal Komneno” për në Kala.

- ✓ Me Kooperacionin Zvicerian është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit për projektin

“Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në Rajonin e Beratit”, projekt i cili do të shtrihet në një periudhë kohore 5- vjeçare dhe do të bëjë të mundur studimin për menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e Rajonit të Beratit dhe ngritjen e një landfilli, i cili do të përpunojë mbetjet e diferencuara .

- ✓ Vazhdon intensivisht puna për rehabilitimin e rrjetit ujësjellës - kanalizime, nëpërmjet kredisë së

Bankës Gjermane KFW, investim i cili do të zgjidhë brenda vitit 2017 furnizimin me ujë të qytetit të Beratit.

- ✓ Me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, u realizua investimi i rrugës “Naim Frashëri”

pranë Sheshit Teodor Muzaka duke mbyllur ciklin e investimeve në Pedonalen e Qytetit

- ✓ Në vitin 2017 do të vijojë bashkëpunimi i ngushtë për investime në Qendrën Historike dhe mbështetje për Zonën e Biznesit BID.
- ✓ Prezenca e Agjensisë Amerikane për Zhvillim USAID, ka qenë prezente në fushën e financave, taksave dhe shërbimet publike për ngritje kapacitetsh dhe logjistikë për stafin e bashkisë. Në vitin 2017, do të vijojë puna në këta sektorë, duke qenë bashki e përzgjedhur ndër 5 bashkitë pilot të USAID në Shqipëri.
- ✓ Bashkia Berat, në bashkëpunim me Organizatën Franceze të Qyteteve të Artit dhe Historisë, kanë filluar punën për Projektin “Zhvillim i Qëndrueshëm në Lagjen Goricë”. Projekti synon asistencë teknike të ekspertëve Francezë në restaurimin dhe rijetezimin e Lagjes Goricë, me funksion zhvillimin e turizmit kulturor.
- ✓ Vazhdon projekti në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara PNUD, për integrimin social të popullatës romë në qytetin e Beratit dhe mbështetja për Qendrën Komunitare Rome.
- ✓ Në bashkëpunim me organizatën Risi Albania do të behet e mundur ngortja e tregut artizanal në Pedonalen e qytetit .
- ✓ Organizata Cesvi, dhe bashkia Berat, do fillojë implementimin në muajin Shtator 2017 të projektit për turizmin dhe trashëgiminë në qytet. Projekti do të shtrihet në një periudhë 3- vjeçare dhe fokusi i projektit është turizmi rural dhe kulturor, gastronomia si dhe artizanati.
- ✓ Gjatë vitit 2016-2017, bashkia Berat, ka aplikuar me 11 projekte në fushën e trashëgimisë, turizmit dhe agrobiznesit, në kuadër të Thirrjeve të Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë :

a- Programi Adrion

b- Programi Ndërkufitar Shqipëri- Greqi

c- Programi i Mesdheut

d- Programi Interreg Ballkan



Bashkia Berat

- ✓ Me Kompanine TAP Shqiperi do te behet e mundur rikonstrukcioni I dy shkollave ne Uznove dhe Veterik dhe ndertimin e nje kopshti per femijet ne Dyshnik. Gjithashtu po aplikohet per te mundesuar mbeshtetjen e dy projekteve te tjera komunitare : Mobilimi i brendshem i Bibliotekes Berat dhe Qendres Komunitare ne Kala.
- ✓ Me kompanine e Naftes Shell do te behete e mundur mbeshtetja per disa evente kulturore dhe panaire kulturore ne fshatrat perreth Malit Shpirag.
- ✓ Ne kuadrin e Programit IPA Competitiveness 2017, Berati do te jete pjese e financimit nga Delegacioni i BE dhe Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) , per projekte infrastrukturore ne funksion te rritjes se turizmit. Bashkia Berat ka aplikuar per mbeshtetje per disa projekte qe rrisin aksesin ne Malin e Tomorrit dhe Qendren Historike.

Sporti

Përshkrimi i programit

Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv, perfshi te gjitha disiplinat sportive, në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

Politika e Programit

Politika e këtij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes ne aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Klubi i Futbollit “FK Tomori 1923” sh.a.**
- **Klubi shumë-sportit “Tomori”**
- **Donatore dhe partner**

Objektivat e politikës së programit

- Vazhdimi i ecurise drejt ngitjes se ekipit te futbollit ne nivelet me te larta ne kategorine superiore, aktualisht ndodhemi ne kategorine e pare.
- Vemendje do te vijoj ti kushtohet edhe ekipeve zinxhir te moshave U-17, U-19.si dhe formimi i nje akademie te mirefillte futbollit.
- Rritja e cilësisë sportive te të rinjve pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, si ping pongut, bilardos, basketbollit, gjimnastikës, mundjes, boksit, karatesë, peshëngritjes, futbollit të ngritura pranë klubit te Shumsportit.
- Arritja e sukseseve kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipit ping pongut, mundjes, karates, boksit dhe sporteve te tjera.



Produktet që synohen të ofrohen.

1. Vazhdimin e projekteve të Bashkisë për shtimin e hapsirave sportive, këndeve sportive, duke bere te m un dur tërheqjen e sa me shume aktiviteteve me karakter kombëtar ne qytetin tone, per te rritur impaktin ndaj shoqerise.
2. Nxitja e aktiviteteve sportive të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës.
3. Përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe hartimi i politikave me motot “ Spotri per te gjithë”, “Vrapo per jeten”, do te jete angazhimi parësor per përfshirjen e komunitetit sa me prane sportit per jete te shendereshme.

PROGRAMI I MIRMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES NE UJITJE DHE KULLIM

Pershkrimi i Programit

Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitse dhe kulluse parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të kanaleve kryesore, kanaleve te dyta me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin. Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e të gjithë përfituesve.

Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë edhe për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, si dhe për të nxitur mbrojtjen e mjedisit.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë Berat, me qëllim që t’iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në cdo parcele toke , krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluse.

Objektivat dhe programet e Qellimit:

1. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve ujitse.

- Reabilitimi i kanalit ujites Gjeroven-Starove
- Reabilitimi i kanalit ujites Starove-Remanic
- Reabilitimi i kanalit ujites Duhanas
- Reabilitimi i kanalit ujites Ullinjas
- Reabilitimi i kanalit ujites Mbolan
- Reabilitimi i kanalit ujites Lapardha 2
- Reabilitimi i kanalit ujites Lapardha 1
- Reabilitimi i kanalit ujites Morave
- Reabilitimi i kanalit ujites Otlak
- Reabilitimi i kanalit ujites Uznove



Bashkia Berat

2. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve Kulluse.

- Pastrimi i kanaleve kulluse ne fushen e Staroves.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne fushen e Lapardhas.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Morave.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Otlak
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Dushnik.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Orizaj.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Uznove.

3. Përmirësimi i kushteve ne burimet ujore “Rezervuaret”

- Mirmbajtja e saraqineskes ne rezervuarin e Mjeshoves.
- Zhbllokimi i pusetes se shkarkimit ne rezervuarin e Roshnikut.
- Zhbllokimi i pusetes se shkarkimit ne rezervuarin e Uznoves.
- Zhbllokimi dhe reabilitimi I shkarkuesit katastrofik ne rezervuari e Mbolanit.
- Reabilitimi I shkarkuesit katastrofik ne pjesen fundore te rezervuarit Ullinjas.

Më konkretisht projektet e programuara për tu mirmbajtur për vitet 2018, 2019 dhe 2020 ne Kullim dhe Ujitje janë :

- Objektet ne kullim.

Nr	Emri i kanalit kullues (sipas inventarit, kollona B)	Kanal te I (pare) ne km	Kanal i II (dyte) ne km	Volumi kanale I (pare) ne m3	Volumi kanale II (dyte) ne m3	Vlera e shpenzimit ne leke	Siperfaqja qe i permiresohet
							kullimi nga kjo
							mirembajtje
							ne ha
1	KK Orizaj		5		9,700	688,312	300
2	Dyshnik Stream (Parangoi)	1	5	3,000	8,000	780,560	200
3	KK Lapardha		5		10,000	709,600	400
4	KK Morave		4		7,500	532,200	100
5	KK Gjolet		2		4,500	319,320	50
6	Starove Field		2		5,000	354,800	250
7	KK-Uznove		2		4,000	283,840	100
Shuma						3,668,632	



Bashkia Berat

Objektet ne ujitje.

Emri i objektit/Skemes	Kanal te I (pare) gjithsej ne km	Kanal i II (dyte) gjithsej ne km	Volumi kanale I (pare) gjithsej ne m3	Volumi kanale II (dyte) gjithsej ne m3	Volumi I pastrimit me mjet+krah m3	Vlera e shpenzimit ne leke Pastrime me mjet	Vlera e shpenzimit ne leke Pastrime me krah
KU Orizaj		6.2		4650.00	1000+3650	141,920	2,638,950
Starove÷Reamnice	7.00		8,000		8000+0	567,680	
Balte e kuqe+dega e Perondis		3		3000.00	3000+0	212,880	
KU Gjeroven-Starove	7.20		1,000		0+1000		723,000
Ullinjas	4.00		900		0+900		650,700
KU Morave		1.5		1500.00	1000+500	70,960	361,500
KU Lapardha 2		4.5		3400.00	1500+1900	106,440	1,373,700
Shuma						=1,099,880	=5,747,850
Shuma Totale						=6,847,730	

❖ Projektet e programuara për investime per tu realizuar për vitet 2017, 2018 dhe 2019 janë :

1.Kanali ujitës Ullinjas

Kanali Ujitës BRU-27 Ullinjas

Nr .	NR. ANALIZ E	EMERTIMI I PUNIMIT	NJESI A	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	3,44/1	Germim dheu kanalesh sek. detyruar me krahe	m3	917.00	723.00	662,991.00
2	2,426/3	Prishje shtrese betoni veshje kanali	m3	835.00	3,509.00	2,930,015.00
3	3,59/a	Germim dheu themel muri mabjtes	m3	3.30	637.00	2,102.10
4	3.243	Beton per mure e themele mbajtes C16/20	m3	7.30	11,010.00	80,373.00
5	3.243	Veshje kanali me beton C16/20 t=8cm	m3	835.00	11,010.00	9,193,350.00
6	An.	Ndertim Prize 40*50cm e re	cop e	3.00	53,598.70	160,796.10



Bashkia Berat

7	An.	Ndertim tombino Betoni ø500mm L=5m	cop e	3.00	92,085.50	276,256.50
8	An.	Ndertim Ure kembesore HD=1m B=2m	cop e	2.00	11,508.15	23,016.30
9	3.243	Beton per HD Tombinosh ekzistuese	m3	5.10	11,010.00	56,151.00
10	4.70	F.V. Tub Celiku ø324mm L=12ml	ton	0.53	167,073.0 0	88,548.69
11	2.20	Lyerje me bitum e katrama e tubit te celikut	m2	12.10	696.00	8,421.60
12	2,37/5	Transport materialesh me auto deri 5 km	m3	1,200.0 0	319.00	382,800.00
		Shuma				13,864,821.2 9
		TVSH 20%				2,772,964.26
		Shuma pergjithshme				16,637,785.55

Projekti ndodhet ne Qendra Transferimit Teknologjive Bujqesore (Fush Kruje) dhe ne Ministrine e Bujqesise

4. PROGRAMI I PLANIFIKIMIT TE MBROJTJES DHE SHTIMIN E SIPERFAQES **PYJORE**

Realizimi i ketij programi ne kete sektor ka nje ndikim ne rritjen e turizmit ,eliminimin e erozionit, rritjen e fiqis punetore, krijimin e nje mjedisi sa me te paster, uljen e ndotjeve te ajrit etj. Pyllzime te reja,sistemime malore,trajtime silvikulturore ne Njesite Administrative Velabisht,Otlak,Roshnik,Sinje.

Qellimi. Menaxhimin e qendrueshem dhe afat gjate te pyjeve dhe kullotave , shtimin e te ardhurave ne buxhetin lokal nga shfrytezimi i burimeve natyrore .

Programi Strategjik O2P7: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesem per menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale.

Projektet:

- 1.Hartimi i planit afatmesëm për manaxhimin e pyjeve dhe kullotave
- 2.Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë.

Objektivat

1. Hartimi i projekteve te reja ne pyllzime ,sherbime kulturore ,sistemime malore ne ndertime pritash, lerash dhe reabilitimin e rugeve pyjore.
2. Ngritja e strukture per masat parandaluese kunder zjarreve.

Detyrat

- 1 .Zbatimi i monatoriumit ne pyje me ndalim te veprimtarise se shfrytezimit te lendes drusore ne fondin pujor (perjashtim etem per nevoja te komunitetit per dru zjarri).



Bashkia Berat

2. Parandalimin e hapjes se siperfaqeve pyjore me qellim ndryshim destinacioni(ulishte, vreshta etj).

IV.PROGRAMI I SHERBIMEVE VETERINAR

I. **Qellimi** : Mbrojtja e shendetit publik nga semundjet Zoonoz te transmetueshme nga konsumimi i produkteve e nenprodukteve shtazore si dhe kontakti me kafshet e gjalla

2. Objektivat Buxhetore Afatmesme

1. Mbrojtja e shendetit publik nga semundjet Zoonoz te transmetueshme nga konsumimi i produkteve e nenprodukteve shtazore si dhe kontakti me kafshet e gjalla
2. Zbatimi i legjislacionit veterinear : ligji nr.10465 dt29.09.2011 “ per sherbimin veterinear’
3. Mbajtja nen kontroll e situates epidemiologjike per semundjet .
4. Sensibilizimi i publikut nepermjet medias se shkruar dhe elektronike.

3. Detyrat e sektorit te veterinarise.

1. Kontoll dhe marje masash ne zbatim te legjislacionit veterinar.
2. Elemini i tregtimit te pa ligjshem ne tortuar ne qytetin e beratit te produkteve dhe nenprodukteve shtazore, kafshe te gjalla , peshku,etj ne bashkpunim me policin bashkiake dhe specialist te mjedisit dhe AKU-se.
3. Kontroll dhe marje masash administrative ne njesit e tregtimit te mishit per munges dokumentacioni dhe kushte higjeno_sanitare.

5. PROGRAMI I SEKTORIT TE BUJQESISE

Ky sektor eshte i fokusuar ne zbatimin e VKM 994 DT 09.12.2015 “Per procedurat e regjistrimit te akteve te marrjes se tokes ne pronesi.” Ky realizim vjen si rezultat i bashkpunit me ZVRPP dhe prefektura.

Objektivi Strategjik 4:

Zhvillimi i sektorit te bujqesisë dhe blegtorisë ne funksion te zhvillimit rural dhe uljes se papunesise.

Programet strategjik 4 .

Programi Strategjik O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkerendimi i punes me institucionet qendrore per sistemin e ujrave te larta te stuhive .

Projektet

- 1.Rehabilitimi i stacionit të elektropompave
- 2.Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta.
- 3.Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Osum
- 4.Inventarizimi i infrastrukturës ekzistuese
- 5.Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese
- 6.Mbrojtja nga permbytjet në zone Rehabilitimi i argjinatures mbrojtese



Bashkia Berat

Programi Strategjik O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore nga zhvillimet urbane.

Projektet

1. Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja

2. Replikimi i modelit të hartuar në projektin pilot në njësi të ngjashme strukturore

Programi Strategjik O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa bujqësore) përmes PPV dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve.

Projektet

1. Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki.

2. Përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki

3. Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore

4. Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blektorale në zonat e përshtatshme

Programi Strategjik O4P4: Mbarështimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në bujqësi e blegtori.

Projektet

1. Hartimi i politikave për kultivimin e tokave bujqësore dhe kullotave nëpërmjet subvencioneve.

KAPITULLI IV

Alokimi i fondeve sipas programeve

Alokimet e fondeve sipas programeve për vitet e planifikuara 2018-2020 paraqiten në tabelën bashlelidhur.

Tabela Nr. 1 “Parashikimi i të ardhurave afatmesme të njësisë së vetëqeverisjes vendore”

Tabela Nr. 2 “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme të njësisë së vetëqeverisjes vendore”

Tabela Nr. 3 “Formatet e planifikimit të tavaneve afatmesme të shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore”

Tabela Nr. 4 “Investimet afatmesme në nivel projekti”

Tabela Nr. 5 “Kërkesat shtese të programit buxhetor afatmesëm”



Bashkia Berat

Pergatiti : Grupi per Manaxhimin Strategjik.

Qershor , 2017.

- Bledar BLANA N/Kryetar i Bashkise
- Clirim BRISKU N/Kryetar i Bashkise.
- Teuta MUCOGLLA N/Kryetar i Bashkise
- Gezim ZEMA Sekretar i Pergjithshem
- Sllavi DHRAMI Drejtor i Urbanistikes dhe Planifikimit te Teritorit
- Erka DURRA Drejtor i Drejtorise Arsimore
- Nevila CAUSHLLARI Drejtor i Taksave, Tregjeve.
- Renuard MIMANI Drejtor i Kultures,Rinise dhe Sporteve
- Hajrie MBRATI Drejtore e Transpotit,Emergjencave dhe shërbimeve
- Meleqe SPAHIU Drejtore e Menaxhimit te Pronave
- Fitim RRAPAJ Drejtori i Bujqesise, Administrimit te Pyjeve, Ujrave
- Pelivan SINAJ Drejtor i Drejtorise se Sherbimeve Publike
- Rexhep HADERI Drejtor i Nd. se Gjelberimit
- Xhevo MUZHAKA Audititi i Brendshem
- Luiza BAZAJ Drejtore e Finances (Sekretar i GMS)

Kryetari i Bashkisë

Petrit SINAJ



Bashkia Berat

PROJEKT-VENDIM

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2018-2020

Kryetari i Bashkise pasi u njohe me materialin e paraqitur nga Grupi per Menaxhim Strategjik, ne mbeshtetje te Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, i ndyshuar , Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 10/1 date 28.02.2017 “Per pergatitjen e buxhetit vendor”, Ligjit nr. 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”

PROPOZON;

1. Te miratoje: Programin Buxhetor Afatmesem 2018-2020 sipas tabelave bashkëlidhur.
Tabela Nr. 1 “Parashikimi i te ardhurave afatmesme te njësisë se vetëqeverisjes vendore”
Tabela Nr. 2 “Parashikimi i shpërndarjes se burimeve financiare afatmesme te njësisë se vetëqeverisjes vendore” .
Tabela Nr. 3 “Formatet e planifikimit te tavanëve afatmesme te shpenzimeve te njësisë se vetëqeverisjes vendore”
Tabela Nr. 4 “Investimet afatmesme ne nivel projekti”
Tabela Nr. 5 “Kërkesat shtese te programit buxhetor afatmesëm”
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Grupi per Menaxhim Strategjik.

KRYETARI I BASHKISE

Petrit SINAJ

JURISTE

Nertila KADENA

SEKRETARE E KESHILLIT

Ledina GJOROVENI